EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XIX, nr. 5697
E premte, 8 shkurt 2019
çmimi 0.40 €

DIALOGU ARTISTIK

FAQE 11

Shkruan:
Ragip SHALA

Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

FLET PËR 'EPOKËN E RE', LISEN BASHKURTI

FAQE 4-5

TAKSA NUK DËMTON RAPORTET KOSOVË - SHBA

Profesori i marrëdhënieve ndërkombëtare, diplomati Lisen Bashkurti, ka bërë me dije se mospezullimi i taksës ndaj produkteve të Serbisë nuk dëmton aspak raportet Kosovë - ShBA. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se kjo taksë si masë mbrojtëse e Kosovës ndaj ofensivës diplomatike serbe duhet të mbetet në fuqi. Bashkurti ka thënë se diplomacia e Kosovës duhet të jetë shumë më aktive në nivele ndërkombëtare për të përdorur argumente konkrete dhe të besueshme në mbrojtje të politikës së vet rreth taksës prej 100 përqindësh. "Diplomacia e Kosovës duhet të tregojë se Serbia është faktori kryesor që është duke penguar dialogun me Kosovën", ka theksuar Bashkurti

Qeveria zotohet për zbatimin e Agjendës për Reforma Evropiane

Agjenda për Reforma Evropiane (ERA) duhet të përmbushet në afat optimal meqë është rruga e vetme e Kosovës për të ecur përpara. Kështu është thënë të enjten nga zyrtarët qeveritarë në takimin e Këshillit Ministror për Integrim Evropian. Me këtë rast kryeministri Ramush Haradinaj ka shprehur përkushtimin e Qeverisë së Kosovës që ERA II të realizohet brenda afatit të paraparë. Ndërsa ministrja e Integrimit Evropian, Dhurata Hoxha, ka bërë me dije se Agjenda për Reforma Evropiane II ka gjithsej 19 prioritete të ndara në tri shtylla, të cilat duhet të realizohen deri në fund të vitit 2020

FAQE 3

Më 11 shkurt hapet konkursi për rekrutim - ushtarë për shërbim aktiv në FSK

FAQE 7

AKTUALE

THAÇI MERR MBËSHTETJEN E SHBA-SË PËR MARRËVESHJEN KOSOVË - SERBI F. 2

AMBSADORI KOSNETT VIZITON POLICINË E KOSOVËS F. 5

KUVENDI DO TË DEBATOJË PËR ABUZIMIN SEKSUAL NDAJ TË MITURËS NË DRENAS F. 7

EKONOMI

NËNSHKRUHET MARRËVESHJA PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT PËR KADASTËR ME BANKËN BOTËRORE F. 9

NË GJAKOVË DO TË HAPEN 130 VENDE TË REJA TË PUNËS F. 9

EKONOMI

KOSOVA MERR KRYESIMIN E RYCO-S, MINISTRI GASHI KRYESON KËSHILLIN DREJTUES TË SAJ F. 5

SPORT

DY SYNIMET E SHILLOVËS F. 13

PALLACANESTRO VARESE, KUNDËRSHTARE E PRISHTINËS NË FIBA EUROPE CUP F. 14

RENOVA PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht –Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · ÇUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan , Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Thaçi merr mbështetjen e ShBA-së për marrëveshjen Kosovë - Serbi

Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka thënë se në takim me sekretarin e Shtetit, Mike Pompeo, u rikonfirmua edhe një herë përkrahja e plotë e ShBA-së për dialogun dhe për arritjen e një marrëveshjeje gjithëpërfshirëse dhe finale të paqes ndërmjet Kosovës dhe Serbisë

PRISHTINË, 7 SHKURT - Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka takuar në Uashington sekretarin amerikan të Shtetit, Mike Pompeo. Nëpërmjet një postimi në llogarinë e vet në "Facebook", ai ka shkruar se u rikonfirmua edhe një herë përkrahja e plotë e ShBA-së për dialogun dhe për arritjen e një marrëveshjeje gjithëpërfshirëse dhe finale të paqes ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. "Si gjithmonë, kënaqësi e veçantë të bisedoj me sekretarin e Shtetit të ShBA-së, Mike Pompeo. Edhe sot, në Lutjet e Mëngjesit, biseduam për zhvillimet në Kosovë dhe në rajonin e Ballkanit Perëndimor. U rikonfirmua edhe një herë përkrahja e plotë e ShBA-së për dialogun dhe për arritjen e një marrëveshjeje gjithëpërfshirëse dhe finale të paqes ndërmjet Kosovës dhe Serbisë", ka shkruar Thaçi.

Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, gjatë qëndrimit në Uashington është takuar edhe me Nancy Pelosi, një mike e vjetër e Kosovës. "Nancy Pelosi është mike e vjetër e Kosovës dhe për këtë i shpreha mirënjohje gjatë Lutjeve të Mëngjesit. Në Uashington, kur është në pyetje Kosova, të gjithë flasin me një zë në përkrahje të marrëveshjes së paqes", ka shkruar Thaçi në llogarinë e vet në "Facebook".

Ndërkaq, në një intervistë për "Zërin e Amerikës", presidenti Thaçi ka folur për taksën e vendosur ndaj produkteve të Serbisë dhe Bosnjës. Ai ka thënë se Kosova ka insistuar që të vazhdojë dialogu, pavarësisht taksa. Thaçi ka treguar se ndaj kësaj çështje kanë një këshillë këmbëngulëse prej Uashingtonit dhe prej Bashkimit Evropian që, së paku, për tre muaj taksa të pezullohet. "Jam optimist në vendime të drejta, në vendime strategjike. Jam optimist se Kosova nuk do ta marrë barrën e bllokadës së procesit të negociatave. Ne kemi insistuar që të vazhdojë dialogu, pavarësisht taksa, por kemi një këshillë këmbëngulëse edhe prej Uashingtonit, edhe prej Bashkimit Evropian që, së paku për disa kohë, tre muaj ose katër, të pezullohet kjo çështje që t'i hapet mundësi e re vazhdimit të dialogut dhe mundësi arritjes së një marrëveshjeje paqësore në mes të dy vendeve", ka thënë Thaçi.

Meta: Roli i Engelit, i pazëvendësueshëm në çështjet shqiptare

TIRANË, 7 SHKURT - Presidenti i Shqipërisë, Ilir Meta, u prit në Kongresin amerikan nga kongresisti Eliot Engel, njëkohësisht kryetar i Komisionit për Politikën e Jashtme. Presidenti Meta falënderoi kongresistin Engel për rolin e tij të pazëvendësueshëm jo vetëm për forcimin e marrëdhënieve shqiptaro-amerikane, por veçanërisht për angazhimin e tij të pakursyer për çështjen shqiptare në çastet më të vështira historike për kombin, çlirimin e pavarësinë e Kosovës dhe anëtarësimin e Shqipërisë në NATO.

Presidenti Meta shprehu besimin se Engeli do ta vijojë angazhimin e tij për të ndikuar në një vëmendje më të madhe të administratës amerikane jo vetëm në raportet dypalëshe, por veçanërisht në sfidat euro-atlantike që po kalon rajoni. "Një vëmendje e veçantë duhet ta përfshijë Kosovën, që ndodhet në një moment të rëndësishëm për finalizimin e një marrëveshjeje me Serbinë, që do të jetë e qëndrueshme, afatgjatë dhe do të sjellë siguri dhe stabilitet në rajon", u shpreh presidenti Meta.

Kongresisti Eliot Engel siguroi presidentin Meta për angazhimin e tij të vazhdueshëm për forcimin e arritjeve të derisotme në rajon falë përkushtimit të ShBA-së për paqen dhe lirinë.

Presidenti Meta mori pjesë në Mëngjesin e Lutjeve në prani të presidentit të ShBA-së, Donald Trump, senatorëve, kongresistëve, si dhe personaliteteve politike e fetare nga e gjithë bota.

Presidenti Meta u takua me sekretarin e Departamentit të Shtetit, Mike Pompeo, me të cilin bisedoi për partneritetin strategjik mes dy vendeve, sfidave të përbashkëta globale, veçanërisht për rolin e pazëvendësueshëm të ShBA-së për forcimin e sigurisë dhe stabilitetit në rajonin e Ballkanit.

Presidenti Meta pati gjithashtu një takim miqësor me kryetaren e Kongresit amerikan, Nancy Pelosi, të cilën e uroi për zgjedhjen e saj në këtë detyrë të rëndësishme, duke nënvizuar rolin e rëndësishëm që Kongresi amerikan ka për mbështetjen e Shqipërisë dhe promovimin e demokracisë dhe shtetit të së drejtës.

Protestë në Tiranë: Rama e Veliaj të ikin nga Shqipëria

TIRANË, 7 SHKURT - Një protestë u zhvillua të enjten në mbrëmje para godinës së Bashkisë së Tiranës. Qytetarët e Tiranës i janë përgjigjur thirrjes së opozitës, duke protestuar në qendër të Tiranës. Dhjetëra qytetarë kanë kërkuar largimin e kreut të Bashkisë së Tiranës, Erion Veliaj dhe kryeministrit Edi Rama, ndërsa janë shprehur se "politikanëve të korruptuar u ka ardhur dita për t'u larguar nga vendi".

Me pankarta në duar "E duam bashkinë pa Erion Velinë", "E duam Shqipërinë pa Edi Ramën", "Rama e Veliaj të ikin nga Shqipëria", ata u shprehën se përballja e madhe me qeverinë do të jetë ajo më 16 shkurt.

Për më shumë se 30 minuta protestuesit kanë bllokuar rrugën mes Bashkisë së Tiranës dhe Teatrit Kombëtar, duke hedhur parulla kundër qeverisë si shkaktare për jetën gjithnjë e më të vështirë e më të shtrenjtë në Tiranë.

Në fjalën e tyre qytetarët u shprehën se në Tiranë jetojnë vetëm ata që kanë lidhje me qeverinë dhe bashkinë e Tiranës, ndërsa të tjerët kanë zgjedhur arratinë si të vetmen alternativë, pasi nuk ka zgjidhje tjetër.

Pas bllokimit të rrugës, protestuesit dhe qytetarët i janë bashkuar edhe protestës së "Aleancës për Mbrojtjen e Teatrit".

EPOKA E RE

Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

Mbahet takimi i rregullt i Këshillit Ministror për Integrim Evropian

Qeveria zotohet për zbatimin e Agjendës për Reforma Evropiane

Agjenda për Reforma Evropiane (ERA) duhet të përmbushet në afat optimal meqë është rruga e vetme e Kosovës për të ecur përpara. Kështu është thënë të enjten nga zyrtarët qeveritarë në takimin e Këshillit Ministror për Integrim Evropian. Me këtë rast kryeministri Ramush Haradinaj ka shprehur përkushtimin e Qeverisë së Kosovës që ERA II të realizohet brenda afatit të paparë. Ndërsa ministrja e Integrimit Evropian, Dhurata Hoxha, ka bërë me dije se Agjenda për Reforma Evropiane II ka gjithsejtë 19 prioritete të ndara në tri shtylla, të cilat duhet të realizohen deri në fund të vitit 2020

EPOKA E RE **Shqipe HETEMI**

PRISHTINË, 7 SHKURT - Këshilli Ministror për Integrim Evropian të enjten ka mbajtur takimin e radhës, në të cilën është diskutuar për zbatimin e Agjendës për Reforma Evropiane (ERA II). Me këtë rast, kryeministri i vendit, Ramush Haradinaj, ka thënë se dinamika e shtuar në qeverisje ka shtuar edhe zbatimin e Agjendës së Reformave Evropiane (ERA II). Sipas tij, falë angazhimit serioz të institucioneve janë finalizuar prioritetet kyçe të ERA II.

Haradinaj ka theksuar se me pakon e ligjeve që fuqizon reformën në drejtësi, dhe atë të reformës së administratës publike, është vendosur themeli rregullativ i funksionimit të shtetit. "Kërkoj ndërveprim institucional dhe dinamikë të shtuar implementuese të kritereve që etapa e dytë e Agjendës për Reforma Evropiane (ERA) të përmbushet në afat optimal. Na mbetet që në periudhën që kemi para vetes, sa iu përket prioriteteve të ERA II, t'i evitojmë mangësitë e të kaluarës, në raste të caktuara pasaktësitë për identifikim të veprimit. Aktorët e përfshirë duhet të jenë ndërveprues dhe të kenë bashkëpunim të mirë ndërinstitucional", ka theksuar kryeministri Haradinaj. Ai ka thënë se takimi i së enjtes i Këshillit Ministror për Integrim Evropian është dëshmi e seriozitetit që kanë institucionet, posaçërisht Qeveria e Kosovës që tashmë ka krijuar një njohuri dhe vetëbesim më të madh dhe nivel të detyrës.

Kryeministri i vendit, Ramush Haradinaj, ka vlerësuar punën që është bërë për zbatimin e prioriteteve të ERA I dhe zbatimin që do të bartet në ERA II, identifikimin e prioriteteve të ERA II për të cilat do të dakordohen për dinamikat implementuese. "Më në fund, ka një qartësi më të madhe në zbatim nga ana e tyre dhe se mund të flitet për sukses", është shprehur ai.

Ndërsa ministrja e Integrimit Evropian, Dhurata Hoxha, ka bërë me dije se Agjenda për Reforma Evropiane II ka gjithsejtë 19 prioritete të ndara në tri shtylla. Ministrja ka treguar se këto prioritete kanë të bëjnë me qeverisjen e mirë, sundimin e ligjit, klimën e investimeve, arsimimin dhe punësimin. "Shtylla e parë: Qeverisja e mirë dhe sundimi i ligjit që i ka pesë prioritete. Shtylla e dytë: Konkurrueshmëria, klima e investimeve dhe zhvillimi i qëndrueshëm që i ka gjashtë prioritete. Dhe shtylla e tretë: Punësimi dhe arsimi që ka tetë prioritete", ka theksuar Hoxha, duke shtuar se zbatimi i Agjendës për Reforma Evropiane ERA II ka një afat kohor deri në fund të vitit 2020. "Duhet ta realizojmë Agjendën e Reformave Evropiane pa asnjë hamendje sa më shpejt ngaqë kjo është rruga jonë e vetme", ka deklaruar Hoxha.

Pjesë e takimit të rregullt të Këshillit Ministror për Integrim Evropian kanë qenë edhe ministri i Financave, Bedri Hamza, ministri i Zhvillimit Ekonomik, Valdrin Lluka, ministri i Arsimit, i Shkencës dhe Teknologjisë, Shyqiri Bytyqi, ministri i Drejtësisë, Abelard Tahiri, ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale, Skender Reçica dhe ministri i Punëve të Brendshme, Ekrem Mustafa, të cilët janë zotuar se do t'i çojnë përpara proceset që lidhen me Agjendën e Reformave Evropiane (ERA II).

Ambsadori Kosnett viziton Policinë e Kosovës

PRISHTINË, 7 SHKURT (ER) - Ambasadori amerikan në Kosovë, Philip S. Kosnett, i shoqëruar edhe nga zyrtarë të ICITAP-it amerikan, ka vizituar të enjten Policinë e Kosovës, ku është pritur nga drejtori Rashit Qalaj. Drejtori Qalaj iu adresua me një falënderim të veçantë ambasadorit amerikan Kosnett për vizitën dhe përkrahjen e vazhdueshme që ShBA-ja ka bërë dhe po vazhdon ta bëjë ndaj Policisë së Kosovës. Qalaj i ka njoftuar të pranishmit se Policia e Kosovës mbetet e përkushtuar për realizimin e detyrave dhe obligimeve ligjore karshi qytetarëve pa dallime, në të mirë të sigurisë dhe rendit në Republikën e Kosovës.

Temë diskutimi e këtij takimi ishin siguria e përgjithshme në Kosovë, lufta kundër të gjitha llojeve të krimit, ngritja dhe forcimi i integritetit dhe kapaciteteve policore, vazhdimi i bashkëpunimit me të gjitha institucionet relevante vendore dhe ndërkombëtare, si dhe synimi drejt anëtarësimit të PK-së në organizata ndërkombëtare.

Ambasadori amerikan Philip S. Kosnett ka vlerësuar përpjekjet dhe kontributet e Policisë së Kosovës për sigurinë e të gjithë qytetarëve dhe gjatë këtij takimi ishte i inkurajuar nga politikat e policisë që kanë të bëjnë me përfshirjen dhe trajtimin e barabartë të të gjitha etniteteve.

Flet për "Epokën e re", Lisen Bashkurti

Taksa nuk dëmton rap

Profesori i marrëdhënieve ndërkombëtare, diplomati Lisen Bashkurti, ka bërë me dije se mospezullimi i taksës ndaj produkteve të Serbisë nuk dëmton aspak raportet Kosovë - ShBA. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se kjo taksë si masë mbrojtëse e Kosovës ndaj ofensivës diplomatike serbe duhet të mbetet në fuqi. Bashkurti ka thënë se diplomacia e Kosovës duhet të jetë shumë më aktive në nivele ndërkombëtare për të përdorur argumente konkrete dhe të besueshme në mbrojtje të politikës së vet rreth taksës prej 100 përqindësh. "Diplomacia e Kosovës duhet të tregojë se Serbia është faktori kryesor që është duke penguar dialogun me Kosovën", ka theksuar Bashkurti

EPOKA E RE **Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 7 SHKURT - Profesori i marrëdhënieve ndërkombëtare, diplomati Lisen Bashkurti, ka mohuar mundësinë që mospezullimi i taksës për mallrat serbe mund të ndikojë në raportet Kosovë - ShBA. Ai ka deklaruar se taksa është një masë bilaterale e vendosur në kushte të imponuara nga politikat agresive serbe kundër Kosovës dhe, si e tillë, nuk duhet të ketë efekte të tjera. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Bashkurti ka deklaruar se kjo masë nuk do të ndikojë aspak në miqësinë dhe bashkëpunimin që ka Kosova me ShBA-në. "Taksa nuk është një masë që është caktuar kundër ShBA-së. Taksa nuk i cenon aspak marrëdhëniet midis Kosovës dhe ShBA-së si marrëdhënie të partneritetit strategjik. Taksa është një masë që nuk ndikon aspak në miqësinë dhe bashkëpunimin që ka Kosova me ShBA-në sepse, në fund të fundit, kjo taksë është një masë që nuk cenon aspak interesat strategjike të ShBA-së", ka thënë Bashkurti.

Ai ka vlerësuar se Serbia është faktori kryesor që po bllokon procesin e normalizimit të raporteve ndërmjet dy vendeve. "Serbia de fakto ka sabotuar sistematikisht dialogun me Kosovën të ndërmjetësuar nga BE-ja. Serbia nuk ka respektuar rreth 90 për qind të marrëveshjeve të arritura në procesin e Brukselit. Serbia në substancë është kundër dialogut për zgjidhjen paqësore të problemeve. Serbia ka shpërfillur dialogun duke kaluar në agresivitet për bllokimin e integrimit të Kosovës në organizatat rajonale. Taksa 100 për qind është një argument i fundit që Serbia po e përdor për ta bllokuar procesin e dialogut", është shprehur diplomati Bashkurti. Sipas tij, diplomacia e Kosovës duhet të argumentojë në arenën ndërkombëtare që bllokuese e dialogut është Serbia. "Mendoj se Kosova, në veçanti diplomacia e saj, duhet të jetë shumë më aktive për të përdorur argumente konkrete dhe të besueshme ndërkombëtare, sepse ka dhjetëra fakte dhe argumente të tilla që diplomacia e Kosovës mund t'i përdorë në nivele ndërkombëtare për ta mbrojtur politikën e vet të taksës prej 100 përqindësh, dhe për të treguar se Serbia është faktore kryesore që e pengon dialogun me Kosovën", ka thënë Bashkurti.

"Epoka e re": *Z. Bashkurti, Qeveria e Kosovës gjendet në një presion të vazhdueshëm ndërkombëtar për heqjen e taksës ndaj mallrave serbe. Si duhet të veprojë Qeveria në këtë rast?*

Bashkurti: Vendosja e taksës 100 për qind për importin nga Serbia ishte një masë politike e imponuar nga politika agresive e Serbisë kundrejt Kosovës. Pa dyshim se kjo taksë e ka shtrënguar ekonominë serbe dhe ka krijuar situatë të vështirë në Serbi. Nga ana tjetër, duhet thënë se një taksë e tillë ka kosto edhe për ekonominë dhe qytetarët e Kosovës. Gjithsesi, mendoj se vendimi i Qeverisë së Kosovës i marrë në rrethana të caktuara është më mirë të mbetet. Kjo taksë nuk është se kërcënon paqen dhe stabilitetin në rajon. Kjo taksë nuk duhet ta pengojë vazhdimin e dialogut ndërmjet dy shteteve. Mendoj se është një taksë që ka faktorizuar dhe e ka përmirësuar balancimin në mes të Kosovës dhe Serbisë. Është një taksë që ka rritur presionin mbi

ortet Kosovë - ShBA



faktorin serb për vazhdimin e dialogut. Gjithashtu, në një nivel ndërkombëtar, është një taksë që ka tërhequr vëmendjen e faktorëve të rëndësishëm ndërkombëtarë për të parë se raportet ndërmjet dy vendeve janë aktualisht mjaft të tensionuara. Në këtë mënyrë mendoj se është një taksë që duhet të vazhdojë. Serbia duhet të bëhet më realiste për ta njohur dhe pranuar realitetin e Kosovës. Serbia duhet të ulet në kushtet e një dialogu pak më të përafërt në raport me Kosovën.

"Epoka e re": *Mirëpo, presioni amerikan ka shkuar duke u rritur në raport me Kosovën. ShBA-ja ka kërkuar pezullimin e kësaj takse për t'i dhënë rast dialogut ndërmjet dy vendeve. Moslargimi i taksës mund të ndikojë në raportet ndërmjet dy vendeve?*

Bashkurti: Taksa nuk është një masë që është caktuar kundër ShBA-së. Taksa nuk i cenon aspak marrëdhëniet midis Kosovës dhe ShBA-së, si marrëdhënie të partneritetit strategjik. Taksa është një masë që nuk ndikon aspak në miqësinë dhe bashkëpunimin që ka Kosova me ShBA-në sepse, në fund të fundit, kjo taksë është një masë që nuk cenon aspak interesat strategjike të ShBA-së. Kjo është një taksë bilaterale e vendosur në kushte të imponuara nga politikat agresive serbe kundër Kosovës. Le të kujtojmë disa çaste kur Serbia dhe Kosova kanë arritur rreth 15 marrëveshje që nga viti 2013. Rreth 90 për qind e këtyre marrëveshjeve nuk janë zbatuar për shkak të qëndrimeve të njëanshme të Serbisë. Shteti i Serbisë ka ndikuar jashtëzakonisht shumë për bllokimin e anëtarësimit të Kosovës në UNESCO dhe Interpol. Në planin më të gjerë global, Serbia ka kaluar në një ofensivë politike dhe diplomatike shumë agresive për të ndikuar që disa shtete që e kishin njohur Kosovën ta tërheqin njohjen. Serbia është në një ofensivë diplomatike kundër shtetit të Kosovës, ndërkohë taksa prej 100 përqindësh e vendosur nga Qeveria e Kosovës është një masë mbrojtëse. Pra, kemi një politikë agresive serbe dhe një masë mbrojtëse nga ana e Kosovës. Prandaj kjo taksë nuk është diçka që bie ndesh me politikën e jashtme të ShBA-së. Në fund, siç e dimë, Shtëpia e Bardhë po aplikon vetë disa tarifa të importit, sidomos në luftën tregtare me Kinën, por edhe me disa partnerë të rëndësishëm, si Kanadanë, Meksikën dhe BE-në. Pra, kjo është thjeshtë një politikë mbrojtëse që një vend mund ta marrë.

"Epoka e re": *Shumë zyrtarë të lartë qeveritarë presionin e ShBA-së dhe të BE-së ndaj Kosovës për këtë çështje e kanë parë si të njëanshëm, duke kërkuar që edhe ndaj Serbisë të bëhet presion?*

Bashkurti: Nuk mendoj se në këtë aspekt po tregohen të njëanshëm. Natyrisht se ka dinamika gjeostrategjike nga ShBA-ja dhe BE-ja. Kryesisht këto dinamika lidhen me rritjen e vëmendjes së Uashingtonit dhe Brukselit për ta mbajtur Serbinë të tërhequr drejt interesave dhe bashkëpunimit euroatlantik, për ta neutralizuar qëndrimin shumë pro rus të Serbisë, si dhe për të krijuar një lloj ekuilibri të ri gjeopolitik në rajonin tonë. Natyrisht se nuk është në interesin e ShBA-së dhe BE-së që ta izolojnë Serbinë brenda Ballkanit Perëndimor, i cili lëviz fuqishëm dhe shpejt drejt interesave euroatlantike. Nuk shoh se ka një politikë favorizuese as nga ShBA-ja e as nga BE-ja pro Serbisë. Mendoj se nuk janë të arsyeshme kritikat që bëhen në këtë drejtim, qoftë nga politika dhe nga mediet, se Brukseli po bëhet shumë pro serb. Serbia është një vend kandidat i BE-së që ka hapur negociatat për anëtarësim, por politika e saj e luhatshme bivektoriale midis Rusisë dhe BE-së është një faktor që e bën BE-në të jetë pak më fleksibile me Serbinë. Kjo nuk ka të bëjë me qëndrime kundër Kosovës, por ka të bëjë me politikë më joshëse ndaj Serbisë.

"Epoka e re": *Në këtë çast Serbia e ka kushtëzuar vazhdimin e dialogut me heqjen e taksës. Si e keni parë këtë kushtëzim të Serbisë?*

Bashkurti: Mendoj se këtu nuk ka asgjë të re. Serbia qysh në fillim e ka penguar dialogun. Serbia ka qenë kundër procesit të dialogut qysh nga viti 2005. Serbia ka qenë kundër procesit të dialogut kur Ahtisari udhëhiqte negociatat mes dy vendeve. Serbia ka qenë kundër tri parimeve të Grupit të Kontaktit: jo kthimit të Kosovës nën Serbi, jo copëtimit të Kosovës dhe jo bashkimit të Kosovës me ndonjë vend tjetër. Serbia de fakto ka sabotuar sistematikisht dialogun me Kosovën të ndërmjetësuar nga BE-ja. Serbia nuk ka respektuar rreth 90 për qind të marrëveshjeve të arritura në procesin e Brukselit. Serbia në substancë është kundër dialogut për zgjidhjen paqësore të problemeve. Serbia ka shpërfillur dialogun duke kaluar në agresivitet për bllokimin e integrimit të Kosovës në organizatat rajonale. Taksa 100 për qind është një argument i fundit që Serbia po e përdor për ta bllokuar procesin e dialogut.

"Epoka e re": *Z. Bashkurti, çfarë duhet të bëjë Qeveria që Kosova të mos jetë fajtore për mosvazhdimin e dialogut ndërmjet dy shteteve?*

Bashkurti: Diplomacia e Kosovës duhet të jetë shumë më aktive në nivele ndërkombëtare për të përdorur argumente konkrete dhe të besueshme në mbrojtje të politikës së saj rreth taksës prej 100 përqindësh. Diplomacia e Kosovës duhet të tregojë se Serbia është faktori kryesor që është duke penguar dialogun me Kosovën dhe e cila nuk dëshiron aktualisht normalizimin e marrëdhënieve me Kosovën, ose që këto marrëdhënie i kërkon në kushte shumë disfavorizuese, për të mos thënë fatale për të ardhmen e Kosovës.

Kosova merr kryesimin e RYCO-s, ministri Gashi kryeson Këshillin Drejtues të saj

Prishtinë, 7 shkurt (ER) - Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Gashi, mori pjesë të enjten në konferencën e Zyrës Rajonale për Bashkëpunim të Rinisë (RYCO), "Fuqizimi i rrugës për pajtim dhe bashkëpunim rajonal. Debati për të ardhmen evropiane të të rinjve kosovarë". Në konferencën e cila është mbajtur në Prishtinë, ministri Gashi ka folur për bashkëpunimin e deritashëm dhe i ka falënderuar drejtuesit e RYCO-s dhe të pranishmit për organizimin e konferencës si dhe për vazhdimin e realizimit të objektivave në të mirë të rinisë.

Këtë vit kryesimin e Bordit Drejtues të RYCO-s do ta ketë Kosova dhe ministri e konsideroi këtë si një privilegj dhe një nxitje për të punuar edhe më shumë për rininë. "Në momentin që po flasim RYCO ndodhet në një pozicion shumë më të favorshëm krahasuar me vitin e kaluar, me një strukturë të konsoliduar dhe me objektiva të qarta strategjike se ku e sheh veten në të ardhmen", ka vlerësuar ministri Gashi, duke shtuar se themelimi i RYCO-s është një mundësi e mirë e shkëmbimeve rinore rajonale e cila duhet të shfrytëzohet nga të rinjtë. Po ashtu, ministri Gashi cilësoi se RYCO bashkëvepron në një mjedis kompleks dhe për këtë duhet më shumë punë për të bërë.

Duke e parë të kaluarën si një sfidë vështirë të tejkalueshme, por jo të pamundur, ministri Gashi si kryesues i Bordit të RYCO-s, por edhe si përfaqësues i Qeverisë së Kosovës në drejtimin e këtij institucioni rajonal, ka thënë se është e nevojshme mbështetja e RYCO-s në mënyrë të veçantë nga ana e gjashtë qeverive të Ballkanit Perëndimor.

RYCO është mekanizëm i pavarur institucional i gjashtë vendeve të Ballkanit Perëndimor, Kosovës, Shqipërisë, Bosnjës, Maqedonisë, Malit të Zi dhe Serbisë për bashkëpunim rajonal në fushën e rinisë.



Më 11 shkurt hapet konkursi për rekrutim - ushtarë për shërbim aktiv në FSK

Kriteret e përgjithshme për rekrut/OR1 (ushtar) të FSK-së do të jenë: Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës; ta ketë të përfunduar shkollën e mesme; të jetë i moshës 18-23 vjeç; të ketë zotësi të plotë për të vepruar; t'i zotërojë aftësitë e nevojshme shëndetësore dhe fizike për vendin e shërbimit si dhe të mos jetë i dënuar për vepër penale, me vendim të formës së prerë

EPOKA E RE Qendresa RAMA

Prishtinë, 7 shkurt - Ministria e Mbrojtjes e Republikës së Kosovës më 11 shkurt do ta shpallë zyrtarisht konkursin publik për rekrutimin e rekrutëve (OR1) - ushtarëve që do të shërbejnë në komponentën aktive të Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK). Afati i konkurrimit do të jetë deri më 22 shkurt.

Konkursi do të shpallet mbi bazën e planit të veprimit 2019 të Ministrisë së Mbrojtjes. Bazuar në këtë plan do të zhvillohet edhe procesi i shqyrtimit, filtrimit dhe përzgjedhjes së rekrutëve të rinj që do të pranohen në FSK.

Kriteret e përgjithshme për rekrut/OR1 (ushtar) të FSK-së do të jenë: Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës; ta ketë të përfunduar shkollën e mesme; të jetë i moshës 18-23 vjeç; të ketë zotësi të plotë për të vepruar; t'i zotërojë aftësitë e nevojshme shëndetësore dhe fizike për vendin e shërbimit si dhe të mos jetë i dënuar për vepër penale, me vendim të formës së prerë.

Procedurat e shqyrtimit, filtrimit dhe përzgjedhjes do të jenë: Shqyrtimi fillestar i aplikacioneve; testi i aftësive; testi fizik; intervista me shkrim dhe me gojë; testi mjekësor; trajnimi; verifikimi; emërimi si dhe e drejta e ankesës.

Dokumentet e kërkuara për aplikim sipas konkursit do të jenë: Diploma (dëshmi) e shkollimeve të përfunduara; dëshmi; certifikata; mirënjohje (nëse ka); certifikata e lindjes (jo me e vjetër se 6 muaj); certifikata e shtetësisë; vërtetimi nga gjykata që nuk është nën hetime apo i ndjekur penalisht; kopje e letërnjoftimit apo pasaportës si dhe dy fotografi të formatit (5 cm x 5 cm).

Shtetasit e Republikës së Kosovës të cilët konkurrojnë mund të pranohen në Forcën e Sigurisë së Kosovës pasi t'i kenë plotësuar kërkesat dhe kriteret e përgjithshme të përzgjedhjes. Pranimi në FSK konfirmohet pas përfundimit të trajnimit bazik dhe gjatë kësaj kohe kandidatët do të cilësohen si rekrutë (OR1).

Pas përfundimit të trajnimit bazik rekrutët marrin gradën e ushtarit.

Formularët për aplikim do të jenë në dispozicion në të gjitha kazermat e FSK-së, si dhe në uebfaqen e Ministrisë së Mbrojtjes, ku do të publikohet edhe konkursi. Formularët duhet të dorëzohen personalisht, në të gjitha kazermat e FSK-së, në çdo ditë pune nga ora 9:00 deri në orën 15:00 deri në afatin e fundit për konkurrim.

Veseli: Pacientët do të jenë në qendër të vëmendjes

Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, së bashku me ministrin e Shëndetësisë, Uran Ismaili, kanë vizituar të enjten Spitalin e Prizrenit. Veseli ka thënë se kjo vizitë po bëhet për t'i uruar punëtorët shëndetësorë për Ligjin e pagave dhe për t'u dëshmuar atyre dhe të gjithë qytetarëve, se shëndetësia është prioritet i institucioneve të Kosovës

EPOKA E RE Faton DËRMAKU

Prizren, 7 shkurt - Kryetari i Kuvendit të Kosovës, njëherësh lider i koalicionit qeveritar, Kadri Veseli, i shoqëruar nga ministri i Shëndetësisë, Uran Ismaili, ka vizituar të enjten Spitalin e Prizrenit, ku kanë bashkëbiseduar me personelin shëndetësor dhe me pacientët për reformat në shëndetësi dhe për krijimin e kushteve më të mira si për personelin shëndetësor, po ashtu edhe për pacientët.

Në hyrje të Spitalit të Prizrenit kryeparlamentari Veseli është ndaluar nga një prind i cili një ditë më parë e kishte operuar fëmijën në këtë spital, ndërsa ka shprehur konsiderata të larta për personelin shëndetësor, i cili fëmijës së tij i kishte ofruar trajtim dinjitoz. Pas vizitës në disa reparte, ku ka takuar personelin shëndetësor dhe pacientë, kryeparlamentari Veseli ka bashkëbiseduar me punonjësit e Spitalit të Prizrenit, të cilët e kanë falënderuar për rritjen e pagave dhe për reformat në shëndetësinë e Kosovës. Veseli ka thënë se kjo vizitë po bëhet për t'i uruar punëtorët shëndetësorë për Ligjin e pagave dhe për t'u dëshmuar atyre dhe të gjithë qytetarëve, se shëndetësia është prioritet i institucioneve të Kosovës në "Dekadën e Re". "Vetëm tani do të hapen mbi 100 vende të lira për mjekë specialistë, sepse i kemi garantuar të gjithë se nuk do të ketë mjekë specialistë të papunë në Kosovë. Do të punojmë shumë që jetën e njerëzve ta bëjmë më të mirë dhe të krijojmë kushte për të jetuar në Kosovë. Kemi arritur një sukses të vogël sepse ende jemi larg nga ku duhet. Do të orientohemi për përmirësimin e kushteve të punës, për ju dhe për pacientët, sepse e kemi obligim dhe këtë do ta bëjmë", ka thënë Veseli.

Ministri i Shëndetësisë, Uran Ismaili, ka theksuar se tani me Ligjin e pagave mjekët kanë pagë të dinjitetshme, ndërsa tani fokusi do të jetë përmirësimi i kushteve për sistemin shëndetësor, në mënyrë që pacientët ta marrin shërbimin e duhur. "Objektiv është që mjekët tanë të mos migrojnë jashtë, por të kontribuojnë në vendin e tyre. Duke ndihmuar punëtorët shëndetësorë që ta ndalojnë migrimin, ne i shërbejmë pacientit të Kosovës. Edhe këtë vit do të shpallim pozita për mjekët tanë dhe do të përpiqemi që pacientët të jenë të kënaqur me shërbimet që ofrohen", ka thënë ai. Ndërsa drejtori i ShSKUK-së, Basri Sejdiu dhe drejtori i Spitalit të Prizrenit, Afrim Avdaj, falënderuan kryeparlamentarin Kadri Veseli dhe ministrin e Shëndetësisë, Uran Ismaili, për reformat dhe investimet që po bëhen në të gjitha nivelet e sektorit të shëndetësisë.

Është mbajtur protesta kundër abuzimit seksual ndaj të miturave

Kuvendi do të debatojë për abuzimin seksual ndaj të miturës në Drenas

Qindra qytetarë kanë protestuar të enjten para stacionit të Policisë së Kosovës në Prishtinë në shenjë pakënaqësie dhe për të kërkuar drejtësi lidhur me dyshimet për përdhunimin e 16-vjeçares në Drenas nga profesori i saj e më pas edhe nga hetuesi policor, i cili e kishte marrë përsipër ta hetonte rastin e përdhunimit të së miturës. Për këtë çështje Kuvendi i Kosovës pritet të mbajë sot (e premte) seancë të jashtëzakonshme

EPOKA E RE Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 7 SHKURT - Me moton "Përdhunuesit në burg" qindra qytetarë kanë protestuar të enjten para stacionit të Policisë së Kosovës në Prishtinë dhe kanë kërkuar drejtësi lidhur me dyshimet për përdhunimin e një të miture në Drenas nga profesori i saj e më pas edhe nga hetuesi policor, i cili e kishte marrë përsipër ta hetonte rastin e përdhunimit të 16-vjeçares.

Në këtë protestë, e cila ka zgjatur rreth një orë, kanë marrë pjesë përfaqësues të shoqërisë civile, zyrtarë të partive politike, deputetë, kryetarë komunash dhe artistë. Në kohën kur po protestohej kundër abuzimit seksual ndaj të miturve, Policia e Kosovës ka njoftuar se ka arrestuar mësimdhënësin me inicialet Sh. Xh., i cili dyshohet se ka abuzuar seksualisht me nxënësen e vet, përkatësisht 16-vjeçaren nga Komuna e Drenasit. Një ditë më parë ky mësimdhënës është suspenduar nga puna.

Po ashtu, Gjykata Themelore e Prishtinës të enjten ka caktuar 30 ditë paraburgim ndaj policit V. V. i cili dyshohet për përdhunimin e një të miture, e më pas detyrimin për abortim. Pas përfundimit të kësaj proteste, grupi parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje, së bashku me grupin parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës dhe deputetët e Alternativës, kanë dorëzuar kërkesën për seancë të jashtëzakonshme lidhur me ngacmimin seksual, përdhunimin dhe kryerjen e abortit të paligjshëm ndaj të miturës dhe përgjegjësinë institucionale.

Subjektet opozitare kanë kërkuar që seanca e jashtëzakonshme të mbahet sot (e premte) në orën 12:00. "Rasti në Komunën e Drenasit shpërfaq një sistem të brishtë të parandalimit, adresimit, mbrojtjes së viktimës dhe dënimit të abuzuesit me detyrë zyrtare në administratën publike. Deri më tani janë trajtuar e shqyrtuar problemet që institucionet i kanë me trajtimin e rasteve të raportuara për abuzime dhe dhunime, por po kuptojmë se sistemi i mbrojtjes ka rrezikë me të mëdha nga ata që janë brenda tij si zyrtarë përgjegjës për mbrojtjen, raportimin dhe këshillimin e të miturve dhe/ose vajzave dhe grave", është thënë në arsyetimin e kërkesës për seancë të jashtëzakonshme.

Tahiri: Do të ndëshkohen ata që abuzuan me të miturën në Drenas

Ministri i Drejtësisë, Abelard Tahiri, ka pritur të enjten në takim ministrin e Punëve të Brendshme, Ekrem Mustafa, kryeprokurorin e Shtetit, Aleksandër Lumezi, dhe drejtorin e Përgjithshëm të Policisë së Kosovës, Rashit Qalaj, me të cilët ka biseduar për rastin e abuzimit seksual ndaj të miturës nga Komuna e Drenasit. Tahiri ka thënë se lajmi për abuzimin e të miturës në Drenas është shqetësues nga çdo këndvështrim dhe një alarm që nuk mund të kalojë pa përgjigje. Ai ka thënë se ky rast do të trajtohet deri në fund dhe çdo shkelje që cenon besimin e qytetarëve në institucione do ta marrë ndëshkimin sipas ligjit. Sipas ministrit Tahiri, abuzimi me pozitën institucionale në çdo nivel është i papranueshëm dhe duhet të ndëshkohet, veçmas kur ky abuzim ndodh nga ata që janë përgjegjës për mbrojtjen dhe sigurinë e qytetarëve. "Me ministrin Mustafa, kryeprokurorin Lumezi dhe drejtorin e Policisë, Qalaj, kemi ndarë shqetësimin e përbashkët rreth këtij rasti si dhe shqetësimet e tjera të qytetarëve tanë që ndërlidhen me sigurinë. Abuzimi me pozitën institucionale në çdo nivel është i papranueshëm dhe duhet të ndëshkohet, veçmas kur ky abuzim ndodh nga ata që janë përgjegjës për mbrojtjen dhe sigurinë e qytetarëve. Ky rast do të trajtohet deri në fund dhe çdo shkelje që cenon besimin e qytetarëve në institucione do ta marrë ndëshkimin sipas ligjit. Institucionet tona të rendit dhe të ligjit do ta vazhdojnë edhe më fuqishëm punën në shërbim të qytetarëve dhe rritjes së sigurisë së tyre. Ky është imperativ i pakompromis", ka deklaruar ministri Tahiri.

Krerët e institucioneve të rendit dhe të ligjit kanë thënë se ky është një rast jashtëzakonisht i rëndë që shpërfaq nevojën e rritjes së llogaridhënies së institucioneve të sigurisë dhe drejtësisë.

Gjatë takimit është kërkuar që përgjigjja ndaj kryerësve të këtij krimi të jetë e menjëhershme dhe përgjegjësit të dalin para drejtësisë. Drejtuesit e institucioneve të sigurisë kanë shprehur përkushtimin për ta vazhduar fuqizimin e sektorit të sigurisë dhe sundimit të ligjit, duke dhënë mesazh të qartë për të gjithë ata që nga jashtë apo brenda përpiqen ta minojnë integritetin e institucioneve, në të cilat qytetarët duhet të kenë besim të plotë.

Ministri Bytyqi kërkon që të thellohet bashkëpunimi në fushën e arsimit me Kroacinë

PRISHTINË, 7 SHKURT (ER) - Ministri i Arsimit, Shyqiri Bytyqi, ka pritur të enjten në takim ambasadoren e Kroacisë në Kosovë, Marija Kapitanoviç, me të cilën ka biseduar për mundësitë e thellimit të bashkëpunimit ndërmjet dy vendeve në sektorin e arsimit. Ministri Bytyqi ka falënderuar ambasadoren Kapitanoviç për mbështetjen që shteti kroat i ka dhënë Kosovës si dhe për interesimin dhe gatishmërinë e Kroacisë për bashkëpunim. Po ashtu, Bytyqi ka theksuar nevojën e hartimit të një memorandumi të bashkëpunimit në mes dy vendeve, sidomos sa i përket shkëmbimit të studentëve dhe profesorëve, edhe shfrytëzimin e mundësive të bashkëpunimit përmes Erasmus+. Ndërkaq ambasadorja Kapitanoviç e ka falënderuar ministrin Bytyqi për angazhimin dhe gatishmërinë për bashkëpunim, duke theksuar se ky bashkëpunim është në interes të dy vendeve, e që më së shumti përfiton rinia.

Hamza: Qeveria është zotuar që t'i vazhdojë reformat e menaxhimit të financave publike

EPOKA E RE A. MAVRAJ

Prishtinë, 7 shkurt - Nën organizimin e Ministrisë së Financave të enjten është mbajtur konferenca me temë "Fuqizimi i kontrollit të brendshëm të financave publike dhe llogaridhënies menaxheriale në subjektet e sektorit publik në Kosovë", në të cilën morën pjesë ministri i Financave, Bedri Hamza, përfaqësuesi i Komisionit Evropian, Raymond Hill, Auditori i Përgjithshëm, Besnik Osmani, përfaqësuesja e SIGMA-së, Miroslawa Boryczka, kryetarët e komunave, kryeshefat e agjencive dhe sekretarët e përgjithshëm.

Me këtë rast ministri i Financave, Bedri Hamza, ka theksuar se Qeveria e Kosovës është zotuar t'i vazhdojë reformat e administratës publike, veçanërisht në shtyllën e tretë të menaxhimit të financave publike që, sipas tij, ndikon në fuqizimin dhe kontrollin e brendshëm për financa publike. Sipas tij, për ta përmbushur këtë zotim Ministria e Financave, me përkrahjen e Komisionit Evropian dhe SIGMA-s, ka hartuar Ligjin për kontrollin e brendshëm të financave publike i cili është miratuar nga Kuvendi i Kosovës në maj të vitit të kaluar.

Ministri Hamza ka thënë se qëllimi i kësaj konference është që përmes saj të bëhet me dije se Kosova synon të avancojë përpara me reformat e administratës publike, për të siguruar një sistem të shëndoshë të menaxhimit të financave publike në harmoni me standardet dhe përvojat më të mira ndërkombëtare. "Ky avancim mundëson një performancë më të mirë të qeverisjes dhe një model të strukturuar e operacional për udhëheqjen e qeverive kombëtare në krijimin e një mjedisi të kontrollit të brendshëm të nivelit të lartë, në veçanti për t'i përmirësuar sistemet e tyre të kontrollit të sektorit publik në linjë me standardet ndërkombëtare dhe praktikat më të mira të BE-së", është shprehur Hamza.

Ndërsa përfaqësuesi i Komisionit Evropian, Raymond Hill, ka thënë se Komisioni Evropian ka mirëpritur miratimin e Ligjit të rishikuar mbi kontrollin e brendshëm të financave publike. "Ky Ligj siguron një kornizë të mirë brenda së cilës menaxherët në sektorin publik mund t'i udhëheqin organizatat e tyre si dhe t'i përmbushin objektivat e Qeverisë në kohë, brenda buxhetit dhe në standardin e performancës. Një administratë publike me performancë të lartë do të kontribuojë në një mjedis më të mirë ku njerëzit mund të jetojnë, mësojnë dhe punojnë. Gjithashtu, në të njëjtën kohë bizneset të zhvillohen në mënyrë më efikase. Komisioni Evropian inkurajon Kosovën që t'i vazhdojë përpjekjet e saj të mira për ta modernizuar më tej rregullimin e qeverisjes publike", ka thënë Hill.

Ilir Murtezaj merr detyrën e drejtorit të ATK-së

Prishtinë, 7 shkurt (ER) - Në Administratën Tatimore të Kosovës (ATK) të enjten është mbajtur ceremonia e pranimdorëzimit të detyrës së drejtorit të përgjithshëm të këtij institucioni nga Bashkim Shala, i cili ishte ushtrues detyre i drejtorit tek Ilir Murtezaj. Emërimi i Murtezajt në këtë pozitë është bërë sipas vendimit të datës 5 shkurt të nxjerr` nga kryeministri Ramush Haradinaj.

Nënshkruhet marrëveshja për financimin e projektit për kadastër me Bankën Botërore

Ministri i Financave, Bedri Hamza dhe udhëheqësi i Bankës Botërore në Kosovë, Marco Mantovanelli, kanë nënshkruar të enjten marrëveshjen për financimin e projektit për kadastër të patundshmërisë dhe infrastrukturës gjeohapësinore. Realizimi i projektit do të bëhet përmes Agjencisë Kadastrale të Kosovës

EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 7 SHKURT - Ministri i Financave, Bedri Hamza, ka vlerësuar lart nënshkrimin e marrëveshjes për financimin e projektit për kadastër të patundshmërisë dhe infrastrukturës gjeohapësinore. Ai ka thënë se kjo marrëveshje ka për qëllim ta rrisë transparencën dhe cilësinë e administrimit të tokës, kualitetin e të dhënave dhe shërbimeve gjeohapësinore. "Përmes këtij projekti do të përmirësohet cilësia e të dhënave kadastrale duke investuar në avancimin e teknologjisë aktuale, zhvillimin dhe përditësimin e regjistrit të ndërtesave si dhe përmirësimin e kushteve të zyrave kadastrale komunale", ka thënë Hamza.

Ai ka bërë me dije se vlera e marrëveshjes është 14.6 milionë euro, e cila karakterizohet si kredi e butë me maturitet afatgjatë prej 30 vjetëve, ku pesë vjet janë grejs periudhë, ndërsa 25 vjet të tjera amortizim i kredisë. "Kostoja vjetore apo interesi është 1.35 për qind, që e bën këtë kredi mjaft të volitshme", ka deklaruar ai. Sipas ministrit Hamza, avancimet që do të arrihen përmes implementimit të kësaj marrëveshje do të jenë shumëdimensionale, duke filluar nga aspekti institucional dhe ligjor me hartimin e strategjisë së përditësuar të Agjencisë Kadastrale të Kosovës. "Përmes kësaj marrëveshje do të ofrohet përkrahja për përgatitjen dhe implementimin e kornizës ligjore dhe rregullative për kadastër si dhe për zhvillimin e studimeve dhe analizave të tregut të tokës, modernizimi i kadastrës nëpërmjet zhvillimit dhe përditësimit të regjistrit të ndërtesave dhe renovimeve në zyrat kadastrale komunale, si dhe avancimi i teknologjisë informative dhe komunikimit si dhe infrastruktura gjeohapësinore duke avancuar teknologjinë aktuale në atë të versionit të fundit", ka theksuar Hamza. Ai ka bërë me dije se vëmendje e veçantë do t'i kushtohet edhe avancimit dhe përditësimit të të dhënave në arkivin digjital si dhe zgjerimi i kuadrit.

Ndërsa menaxheri i Bankës Botërore për Kosovën, Marco Mantovanelli, ka deklaruar se sigurimi i të drejtave pronësore është thelbësor për përmirësimin e rritjes ekonomike dhe zhvillimit të Kosovës. Ai ka thënë se të drejtat e definuara mirë janë gurthemel për një ekonomi dinamike të tregut. Mantovanelli ka shtuar se ky projekt do të ndihmojë që qasja në financa të rritet, ndërsa informaliteti në ekonomi të zvogëlohet, duke ndikuar kështu pozitivisht në tregun e kredive dhe në sektorin bankar komercial, që mund të rezultojë në më shumë investime dhe më shumë vende pune.

Në Gjakovë do të hapen 130 vende të reja të punës

PRISHTINË, 7 SHKURT (ER) - Kryeministri i vendit, Ramush Haradinaj, ka mbajtur të enjten një takim me ministrin e Tregtisë dhe Industrisë, Endrit Shala, dhe kryetarin e Komunës së Gjakovës, Ardian Gjini, në të cilin takim është shpalosur një projekt i rëndësishëm për bujqësinë, i prezantuar nga investitori "Growponics Kosova", investim mbi 10 milionë euro në serë hidroponike, në pesë hektarë tokë në rajonin e Gjakovës. Kryeministri Haradinaj ka thënë se përmes këtij projekti do të krijohen 130 vende të reja të punës dhe do t'i rritë kapacitetet eksportuese të Kosovës. "Klima e përshtatshme, lehtësirat legjislative dhe Ligji për Investime Strategjike po e bëjnë Kosovën destinacion të kërkuar për investime dhe janë bazë e fuqishme që viti i ekonomisë ta bëjë kthesën pozitive në trajektoren e zhvillimit të qëndrueshëm në Kosovë", ka thënë Haradinaj.

QKMF-ja në Drenas po bëhet me sistemin e digjitalizimit

Drenas, 7 shkurt (ER) - Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare "Dr. Hafir Shala" në Drenas është qendra e parë në Kosovë që po bëhet me sistemin informativ (digjitalizim), ku secili pacient do të regjistrohet përmes aplikacionit përkatës.

QKMF-ja në Drenas është vizituar nga përfaqësuesi i Ministrisë së Shëndetësisë, Zenel Hysenaj, me ekipin e tij dhe përfaqësuesi i Bankës Botërore, Dorethee Chan, me ekipin e ekspertëve, për të parë nga afër implementimin e projektit të filluar nga Ministria e Shëndetësisë, respektivisht nga Departamenti i IT-së nga kjo ministri.

Në këtë vizitë ishte edhe nënkryetari i Komunës së Drenasit, Gani Sylaj, drejtori i Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Arsim Haxhiu, si dhe drejtori i QKMF, Ismet Bogiqi.

Ky projekt pritet të jetësohet në gjashtëmujorin e parë të këtij viti ne gjithë rrjetin e kujdesit parësor shëndetësor në Komunën e Drenasit, ku në kohë reale do të përfitonin të gjitha të dhënat e mundshme lidhur me punën dhe procedurat e punëtorëve shëndetësorë dhe pacientëve.

UPZ-ja arrin marrëveshje me STA-n

Prizren, 7 shkurt (ER) - Universiteti "Ukshin Hoti" në Prizren ka arritur protokoll bashkëpunimi me STA (Country Master Distributor for ETS). Qëllimi i këtij bashkëpunimi është ta garantojë bashkëpunimin midis UPZ-së dhe STA-së me qëllim të sigurimit të standardit gjatë procesit të testimit të gjuhës angleze dhe frënge dhe ta garantojë certifikimin zyrtar të rezultatit të arritur gjatë testimit në ambientet e UPZ-së.

Tani studentët e UPZ-së do të kenë mundësi t'u nënshtrohen testeve të ETS të njohura ndërkombëtarisht (TOEFL ITP, TOEIC L&R dhe TFI) në ambientet e këtij universiteti.

Marrëveshjen përkatëse e ka nënshkruar prof. asoc. dr. Ismet Temaj, ushtrues detyre i rektorit në UPZ, dhe prof. ass. Ines Dika, përfaqësuese e STA-së. Kjo marrëveshje është në funksion të implementimit të marrëveshjes në mes të MAShT-it dhe ETS Global BV, e arritur në fund të vitit të kaluar, me qëllim të implementimit të Udhëzimit Administrativ të Zyrës së Kryeministrit për gjuhët e huaja në programet e studimit të ciklit të dytë apo të tretë.

Rektori Temaj e ka vlerësuar këtë bashkëpunim të rëndësisë së veçantë për studentët e UPZ-së që t'i nënshtrohen provimit në njohuritë në gjuhët e huaja, sidomos atë angleze, në një institucion kredibil siç është ETS Global BV.

Berisha: Siguria publike në Malishevë është menaxhuar profesionalisht

Malishevë, 7 shkurt (ER) - Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB) ka mbajtur mbledhjen e parë për vitin 2019, e cila është udhëhequr nga nënkryetari i Komunës së Malishevës, Hajdin Berisha. Ai para anëtarëve të KKSB-së ka folur për sigurinë për vitin 2018, duke konstatuar se, "falë institucioneve përgjegjëse dhe bashkëveprimit profesional, ishte një vit me siguri publike brenda parashikimeve dhe u menaxhua profesionalisht, kurse me praktikat e fituara do të jemi edhe më funksionalë në vitin 2019".

Nga të gjithë të përfaqësuarit në KKSB është zhvilluar debat për situatën e sigurisë në Komunën e Malishevës, për zhvillimet brenda muajit janar. Me këtë rast ata kanë vlerësuar se situata e sigurisë publike është brenda parametrave dhe parashikimeve të parapara. Sipas tyre, një gjë të tillë është duke e ndihmuar edhe fillimi i realizimit të projektit për instalimin e kamerave të sigurisë në qytetin e Malishevës, që është në fazën përfundimtare.

KKSB-ja pas një debati të gjerë ka miratuar planin vjetor të punës, ku parashihen disa objektiva dhe aktivitete brenda vitit 2019, siç janë: bashkërendimi i iniciativave të përbashkëta të mekanizmave institucionalë për zgjidhjen e problemeve të sigurisë të çdo komuniteti, rritja e bashkëpunimit të mekanizmave institucionalë nga fusha e sigurisë publike, vendosja dhe funksionalizimi i video-vëzhgimeve të hapësirave publike në qytetin e Malishevës, realizimi i projektit për vendosjen e video-kamerave, mbajtja e ligjëratave në shkollat e Komunës së Malishevës, botimi i broshurave për sjellje në situata emergjente etj.

KEDS-i vazhdon investimet në rrjetin elektrik në Drenas

Drenas, 7 shkurt (ER) - Nënkryetari i Komunës së Drenasit, Gani Sylaj, së bashku me drejtoreshën e Drejtorisë për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit, Flutura Avdiu, drejtorin e Infrastrukturës Publike, Idriz Hysenaj, kanë pritur në takim drejtorin për investime në KEDS, Hasan Oz, si dhe drejtorin për bashkëpunim me institucione qeveritare dhe kontrollin e investimeve në KEDS, Avni Alidemaj, menaxherin për punë ndërtimore, Faruk Gjyukaj dhe drejtorin e distriktit regjional, Betim Elezaj.

Në këtë takim është diskutuar për problemet e rrjetit elektrik me të cilat përballet Komuna e Drenasit dhe për mundësitë e investimeve në përmirësimin e këtij rrjeti elektrik.

Nënkryetari i komunës, Gani Sylaj, ka theksuar nevojën e madhe për investime në rrjetin elektrik dhe ka shprehur gatishmërinë e ekzekutivit të Komunës së Drenasit për të bashkëpunuar për zgjidhjen e problemeve të furnizimit me energji elektrike për qytetarët e Drenasit. Përfaqësuesit e KEDS-it janë zotuar se për secilin projekt të nisur në Drenas do të bashkëpunojnë me komunën për përmirësimin e rrjetit elektrik.

DIALOGU ARTISTIK

Shkruan: Ragip SHALA

Në raportet Kosovë - Serbi, sa i përket dialogut, kanë dominuar dy forma dialogu: teknik dhe politik. I pari dialog teknik njihet në mes të Murat Gjakës dhe principatës serbe gjatë dëbimit të dhunshëm të shqiptarëve nga krahina e Toplicës më 1877. Pastaj është pasuar nga Azem Bejta gjatë Lëvizjes Kaçake në mes dy luftërave botërore. Derisa M. Gjaka ka dialoguar për pronat dhe shtëpinë e tij, A. Bejta ka dialoguar përtej pragut, ka dialoguar për tre fshatrat e "Arbërisë së vogël".

I pari dialog politik për çështjen e Kosovës ka ndodhur në ujdhesën Vis të Dalmacisë në gusht 1944. Atje përfaqësuesit e ShP të UNÇ të Shqipërisë, në krye me Ramadan Çitakun, i kanë kërkuar Titos, Rankoviqit dhe Gjillasit vetëvendosje për Kosovën! Edhe pas përfundimit të LDB-së ka pasuar dialogu politik për çështjen e vetëvendosjes së Kosovës sipas rezolutës së Konferencës së Bujanit në mes të Titos dhe Enver Hoxhës në Beograd 1946. Pastaj në Moskë në mes të Stalinit dhe Kardelit, si dhe Stalinit e Enver Hoxhës. Pas luftës çlirimtare të UÇK-së, përkundër terrorit shtetëror serb ndaj Kosovës, dialogu Kosovë - Serbi ka "zbritur" në dialog teknik që ka rezultuar me kontrabandim të kishave dhe manastireve paleokristiane arbërore në objekte kulti ortodokse serbe. Kurse si kryevepër e dialogut teknik konsiderohet fusnota, asociacioni, demarkacioni si dhe Gjykata Speciale për ta "shpërlarë" luftën e UÇK-së! Meqë është konsumuar dialogu teknik, tani radhën e ka dialogu politik. Për këtë lloj dialogu, tregun politik në Kosovë e përbëjnë dy rreshtime politike: Lëvizja "joviolente" dhe lëvizja klandestine! Sipas lëvizjes "joviolente", që përbëhet nga struktura të ish-LKJ-së, të konvertuar në "demokratë", çështja e Kosovës si problem politik në raport me Serbinë zë fill me suprimimin e Autonomisë së Kosovës në mars 1989. Sipas lëvizjes klandestine zezona mbi Kosovën daton që nga okupimi serb i Kosovës më 1912. Këtë rreshtim e përbëjnë kryesisht struktura të lëvizjes klandestine të gjeneratave të ndryshme. Meqë lëvizja "joviolente" ka zotëruar hapësirën mediatike, prandaj ka arritur të kultivojë opinione masive që zezona mbi Kosovën ka rënë në "ngritjen" e Millosheviqit. Nën influencën e lëvizjes "joviolente" është "indoktrinuar" një numër jo i vogël i lëvizjes klandestine për vetëm zezonën millosheviqiane, duke "tradhtuar" zezonën titiste, rankoviqiste etj. Nga rrethanat politike, ekonomike të Kosovës, jo vetëm gjatë RSFJ-së, dhe mbretërisë SKS, por edhe më tej, çështja e raporteve Kosovë - Serbi kalon përtej "kryqëzimit" millosheviqian. Si e tillë është çështje tredimensionale, e papërcaktuar në kohë, por e përcaktuar në hapësirë. Thelbin e çështjes së raporteve Kosovë - Serbi e përbëjnë konfrontimet permanente jo vetëm në regjimin e Millosheviqit, por regjimin e Titos dhe Rankoviqit, Pashiqit, Obranoviqit etj. Çështje konfrontimesh permanente në raportet Kosovë - Serbi, përmban konfrontime politike, ekonomike, juridike, diplomatike, gjeopolitike, religjioze, historike, ushtarake etj.

Konfrontimet politike

Që nga mesjeta e hershme, nga invadimi i fiseve sllave në GADISHULLIN ILIRIK konfrontimet politike nuk kanë pushuar deri në ditët tona. Thelbin e konfrontimit politik me Serbinë e përbën "Serbia hyjnore", ku priftërinjtë ortodoksë, përmes liturgjisë mitike, kanë demonizuar shqiptarët si një popull "joqiellor" që duhej shfarosur! Mbase themelet e terrorizmit shtetëror serb ndaj Kosovës qëndrojnë te KOS-i. Prandaj janë hartuar projekte dhe memorandume si: Naqertanja, Platforma politike për Kosovën, Memorandumi i AShA-së serbe, Patkoi etj., që kanë rezultuar me përndjekje, shpërngulje të dhunshme, mizori, vrasje masive, terror shtetëror me përmasa gjenocidi. Gjatë tërë shekullit 19 dhe 20, raportet Kosovë - Serbi karakterizohen me tensione politike, të projekteve nacional shoviniste dhe hegjemoniste serbomadhe ndaj Kosovës.

Konfrontimet ekonomike

Thelbin e konfliktit ekonomik në raportet Kosovë - Serbi e përbën eksploatimi kolonial serb në pasuritë natyrale të Kosovës. Shpronësimi dhe përndjekja e 600 fshatrave nga krahina e Toplicës, "reformat agrare" gjatë mbretërisë SKS, shtetëzimi i pronave gjatë RSFJ-së, plaçkitjet e para dhe gjatë luftës së fundit etj. Serbia me projekte të ndryshme ekonomike e ka privuar popullin shqiptar në qeverisje me pasuritë nëntokësore dhe mbitokësore. Prandaj për këto fakte çështja ekonomike e Kosovës përbën një çështje koloniale.

Konfrontimet diplomatike

Konfliktet permanente politiko-ushtarake Kosovë - Serbi kanë ndikuar që Kosova si subjekt ndërkombëtar të trajtohet nga diplomacia e Fuqive të Mëdha. Prandaj Kosova ka parakaluar nëpër korridoret diplomatike evropiane se nga Kongresi i Berlinit, Konferenca e Londrës, Konferenca e Parisit, Konferenca e Bujanit, Komisioni i Badinterit, Konferenca e Rambujesë etj. Pavarësisht nëse është vendosur drejt apo jo ndaj Kosovës, subjektiviteti diplomatik ndërkombëtar i Kosovës përfshin një periudhë kohore 121-vjeçare (1878-1999)

Konfrontimet juridike

Kosova si vazhdimësi e Dardanisë antike historikisht përbën një entitet të veçantë juridiko-politik. Mbretëri në Dardani, Prefekturë në Perandorinë Romake, Vilajet gjatë Perandorisë Osmane, Krahinë gjatë RSFJ-së. Përkundër entitetit juridiko-politik, çështja e konfliktit juridik Kosovë - Serbi ka të të bëjë me juridiksionin serb, për ta paraqitur Kosovën si pronësi absolute serbe. Pikërisht shkaku i juridiksionit diskriminues serb, çështja e Kosovës ka rezultuar me rezoluta në Parlamentin Evropian, në Kongresin Amerikan dhe, së fundmi, në GjND.

Konfrontimet gjeopolitike

Konfrontimi gjeopolitik Kosovë - Serbi konsiston në pozitën gjeografike të Kosovës si një udhëkryq në mes të lindjes dhe Perëndimit, si dhe rreshtimet politike në drejtime të kundërta, përkrah koalicioneve ndërkombëtare. Që nga beteja e dytë e Kosovës më 1448, pastaj kryengritjet e shumta anti-osmane, kahet gjeopolitike Kosovë - Serbi i karakterizon vazaliteti serb ndaj Stambollit dhe përpjekjet shqiptare për koalicione perëndimore kundër okupimit otoman. Kahet e ndryshme gjeopolitike në arenën ndërkombëtare i karakterizon edhe gjatë shekullit 19 dhe 20. Pranvera republikane e '81-s, krahas Solidarnostit Polak, Kosovën e ka rreshtuar përkrah koalicionit perëndimor. Aleanca pansllaviste në mes të Beogradit dhe Moskës ka ngujuar Serbinë në kursin gjeopolitik lindor. Mbase këto rreshtime gjeopolitike me pole të kundërta kanë kulmuar me aleancë politiko-ushtarake në mes të UÇK-së dhe NATO-s.

Konfrontimet religjioze

Nyjën e tërë konfrontimeve shqiptare-serbe, përkatësisht Kosovë - Serbi, e përbën çështja religjioze, konkretisht objektet e kultit religjioz. Derisa shqiptarët iu përkasin tre religjioneve monoteiste ortodokse, katolike dhe islame, serbët i përkasin vetëm religjionit ortodoks. Shqiptarët janë të parët ndër popujt evropianë që kanë kaluar nga politeizmi në monoteizëm, gjegjësisht në krishterim gjatë shekullit 2 e. Re. Invadimi sllav në Gadishullin Ilirik është invadim fisesh barbare paganiste që u konvertuan në krishterim në kishat paleokristiane arbërore. Islamizimi i popullit shqiptar gjatë mesjetës së vonë u ka hapur shtigje sllavëve t'i zaptonin kishat dhe manastiret arbërore. Konfrontimi religjioz ka kulmuar gjatë luftës çlirimtare të UÇK-së, ushtria vrastare serbe ka rrafshuar për tokë më se 1 000 xhami, kurse kishave dhe manastireve ortodokse nuk u është thyer as edhe një xham nga luftëtarët e UÇK-së.

Konfrontimi historik

Tërë konfrontimet politike, ekonomike, juridike, ushtarake etj. janë në një vazhdimësi historike në mes të popullit shqiptar autokton dhe invaduesve barabarë sllavë. Historia e raporteve Kosovë - Serbi është histori konfrontimesh për tokën, për ujin, për qiellin, për diellin, histori zaptim tokash me dhunë, histori përndjekjeje, shkatërrim, histori gjenocidi fizik, kulturor, gjuhësor ndaj Kosovës. Historiografia serbe për Kosovën është histori e falsifikuar, e ndërtuar mbi mite, si e tillë Kosovën e paraqet si "tokë e shenjtë" serbe, si "djepi serb" etj. Faktet historike janë të pamohueshme që dëshmojnë se Kosova është Dardani dhe kurrsesi "Jerusalemi" serb. Historia serbe në Ballkan zë fill nga shekulli 10, kurse historia e Kosovës zë fill që nga mbretëria e Dardanisë.

Konfrontimet luftarake

Kosova përbën një fenomen të veçantë mbijetese përballë terrorit shtetëror serb, fushatave ushtarake dhe policore serbe. Që nga viti 1878 deri më 1999 çështja e konfrontimeve luftarake e veçon me vrasje masive, shkatërrim, gjenocid ndaj civilëve shqiptarë. Gjatë tërë kësaj periudhe 120-vjeçare ushtria serbe veçohet për ushtrinë më gjakatare, më vrastare në Evropë. Fushatat ushtarake dhe policore të programuara dhe komanduara nga krerët fetarë e shtetërorë serbë janë fushata okupimi dhe kolonizimi ndaj Kosovës. Kundërvënia e armatosur e luftëtarëve shqiptarë është kundërvënie vullnetarësh me armatime modeste, kundërvënie gueriljesh nga Lëvizja Kaçake në mes dy luftërave botërore, deri te kundërvënia e UÇK-së. Tërë përpjekjet shqiptare për kundërvënie luftarake ndaj terrorizmit shtetëror serb janë përpjekje çlirimtare, kundër okupimit dhe kolonizimit serb dhe, si e tillë, përbën një luftë të drejtë të bazuar me të gjitha ligjet ndërkombëtare.

Përfundim

Çështja e relacioneve Kosovë - Serbi është çështje konfrontimesh komplekse më se 120-vjeçare, që nga viti 1878 deri më 1999. Është çështje terrori shtetëror serb me përmasa gjenocidi. Është çështje okupimi dhe kolonizimi ndaj Kosovës. Prandaj shpallja e pavarësisë së Kosovës është krejt e natyrshme dhe e ligjshme, e konfirmuar edhe nga GjND-ja. Dialogu Kosovë - Serbi për një marrëveshje historike duhet të rezultojë me një marrëveshje të drejtë dhe paqësore.

Trumpi: Së shpejti njoftimi për fushatën kundër ISIS-it

Uashington, 7 shkurt - Presidenti Donald Trump tha se parashikon që brenda pak ditësh të bëhet një njoftim zyrtar që konfirmon se koalicioni i udhëhequr nga ShBA-ja ka rimarrë nën kontroll të gjithë territorin që mbante prej dy vjetësh grupi terrorist. Presidenti pohoi se mbetje të grupit terrorist mund të jenë ende aktive në disa pjesë të Sirisë dhe Irakut, por shtoi se ato nuk janë në gjendje të mbledhin taksa apo të gjenerojnë burime financiare për të mbështetur aktivitetin luftarak.

Presidenti Trump foli para Koalicionit Global për të Mposhtur ISIS-in, një aleancë me 79 vende anëtare. "Ushtria e ShBA-së, partnerët tanë në koalicion dhe Forcat Demokratike Siriane kanë çliruar në realitet të gjithë territorin që mbante më parë ISIS-i në Siri dhe Irak. Do të bëhet njoftimi zyrtar së shpejti, ndoshta nga java e ardhshme se ne kontrollojmë 100% të Kalifatit", tha Trumpi. Ai tha se ka ardhur koha për t'i kthyer ushtarët amerikanë në atdhe. Por u bëri thirrje aleatëve të ndjekin shembullin e Amerikës, duke mbrojtur kufijtë nga terroristët që përpiqen të futen. "Duhet ta pranojmë se siguria në imigracion është siguri kombëtare dhe se nuk duhet t'u lëmë luftëtarëve të huaj mundësi të futen në vendet tona. Ne jemi treguar shumë të prerë", tha Trumpi.

A po i vjen fundi zgjerimit të NATO-s?

Anëtarësimi i Maqedonisë Veriore krijon idenë e bujarisë në shikim të parë, mirëpo e vërteta është se dyert e hapura të aleancës ka mundësi që do të mbyllen ashpër, në një të ardhme që mund të parashikohet, pasi Shkupi të kthehet në anëtarin e 30 të NATO-s

Bruksel, 7 shkurt - Jashtë selisë së NATO-s në Bruksel gjendet një monument nga metali, që tregon kohën e anëtarësimit të shteteve në aleancën veriatlantike. Duke nisur nga viti 1949, njëherësh viti kur është themeluar NATO-ja, aty janë gravuar emrat e 12 anëtarëve fillestarë. Rreth 30 centimetra, në anën e djathtë, shihet viti 1952 dhe dy anëtaret e reja të asaj kohe, Greqia dhe Turqia, të përcjella pas 30 centimetrash tjerë nga Gjermania, që është anëtarësuar në aleancë më 1955. Më pas vërehet një hapësirë e madhe, pothuajse tri metra derisa të shfaqet data e radhës, 1982 dhe Spanja që gjendet afër saj, e pasuar nga vendet tjera që më pas janë shtuar ndër vite.

Pas nënshkrimit të protokollit për anëtarësim nga ajo që do të quhet Maqedonia Veriore në të ardhmen më 6 shkurt, një emër tjetër pritet t'i shtohet listës rreth pranverës së vitit 2020, meqë parlamentet e 29 aleatëve tjerë duhet ta ratifikojnë dokumentin. Ky fakt do të rezultojë me hapësirë prej 4 metrash për anëtarësime. Ose rreth 40 vjet, nëse ndiqet logjika e monumentit. Kjo gjë krijon idenë e bujarisë në shikim të parë, mirëpo e vërteta është që dyert e hapura të aleancës ka mundësi që do të mbyllen ashpër, në një të ardhme që mund të parashikohet, pasi Shkupi të kthehet në anëtarin e 30-të të NATO-s.

Aktualisht janë tri shtete që kanë shpërfaqur synimet e tyre për t'iu bashkuar aleancës: Bosnja, Gjeorgjia dhe Ukraina. Nga të tria, Bosnja duket se ka më së shumti mundësi për të realizuar këtë qëllim pasi ka siguruar Planin e Veprimit për Anëtarësim (PVA). Ky plan, që u ndihmon shteteve për të arritur standardet e NATO-s, si dhe i përgatit për anëtarësim të mundshëm në të ardhmen, i është dorëzuar Sarajevës më 2010. Në fund të vitit të kaluar, ministrat e NATO-s kanë inkurajuar Bosnjën që të prezantojë Programin e parë Kombëtar Vjetor, ashtu që të shënojë përparim në PVA. Megjithatë, situata nuk është kaq e thjeshtë sa duket, raporton REL.

Fillimisht, Bosnja nuk ka shumë gjasa që të dorëzojë këtë plan në një periudhë afatshkurtër. Përfaqësuesi serb në presidencën trepalëshe në këtë shtet, Milorad Dodik, ka përmbysur secilën përpjekje, ende ka e arritur cakun kur është bërë fjalë për këtë çështje. Mirëpo e vërteta është edhe se Sarajeva ende nuk e ka përmbushur një kriter që NATO-ja i pati vënë, kur ky shtet është pajisur me Planin e Veprimit për Anëtarësim: regjistrimin e pronave të paluajtshme të fushës së mbrojtjes, si pronë të shtetit, sepse në këtë mënyrë mund të kuptohet nëse shteti boshnjak kontrollon këtë fushë. Përveç kësaj, zyrtarët e NATO-s kanë shprehur shqetësime edhe për përparim të ulët në reforma, sundimin e ligjit, korrupsionit dhe lirisë së medieve. Prandaj rasti i Bosnjës konsiderohet i komplikuar në këtë moment dhe duket se do të vazhdojë të mbetet i tillë.

Kur është fjala për Gjeorgjinë, NATO-ja ka vepruar krejtësisht ndryshe për dallim nga Bosnja. Prej kur këtij shteti i është premtuar anëtarësimi gjatë Samitit të Bukureshtit më 2008, Tbilisi ka prezantuar 10 programe kombëtare vjetore, mirëpo nuk ka ndodhur njëjtë edhe me Planin e Veprimit. Pavarësisht kësaj, NATO-ja vazhdon të jetë e përkushtuar për t'i ndihmuar Gjeorgjisë që të mbrojë veten dhe në mars të këtij viti, ky shtet do të zhvillojë stërvitjet më të mëdha ushtarake. Por, aktualisht shumë shtete të aleancës, sidomos në Evropën Perëndimore janë duke u fshehur pas Gjermanisë dhe Francës, duke pretenduar se anëtarësimi i Gjeorgjisë do të mund të armiqësojë Rusinë.

Ideja e Tbilisit për t'u kthyer në një "Gjermani Perëndimore" duke u anëtarësuar mirëpo duke lënë jashtë rajonet e shkëputura të Abkazisë dhe Osetisë Jugore nga mbrojtja e përbashkët e NATO-s, nuk ka gjetur përkrahje në Bruksel. Zyrtarët e NATO-s kanë thënë jozyrtarisht se do të ishte shumë më mirë sikur Gjeorgjia të fokusohej në arritjen e standardeve të Gjermanisë Perëndimore në fushat siç janë të drejtat e njeriut dhe sundimi i ligjit.

Sa i përket Ukrainës, situata është e ngjashme me Gjeorgjinë, veçse ky shtet është edhe më poshtë në listë. Udhëheqja në Kiev ende nuk ka kërkuar ndonjë plan veprimi, duke dhënë shenja se është duke ndjekur praktikën gjeorgjiane.

Po pjesa tjetër?

Neutraliteti kushtetues i Moldavisë pritet të vazhdojë të mbetet pavarësisht se kush drejton shtetin. Mirëpo edhe nëse kjo gjë nuk do të ekzistonte, ky shtet do të ishte pjesë e grupit të Gjeorgjisë dhe Ukrainës.

Kosova ndoshta mund të konsiderohet kalë i zi nëse marrëveshja për normalizimin e marrëdhënieve me Serbinë do të përfshinte kërkesën, që anëtarët e aleancës që nuk kanë njohur Kosovën si shtet, tani të njohin pavarësinë e saj. Megjithatë, veprimi i fundit i Prishtinës, për të krijuar ushtrinë e vet, nuk ka fituar pëlqimin e disa vendeve të bllokut.

Ndoshta basti më i sigurt në këtë moment, për atë se cilët emra do të jenë të radhës që do të shtohen në monumentin e ndritshëm, ka të bëjë me dy shtete, që tani nuk dëshirojnë të jenë pjesë e aleancës, mirëpo do të pranoheshin nga Brukseli pa menduar dy herë: Finlanda dhe Suedia. Çdokush mund të parashikojë se cili do të jetë ai vit, mirëpo me rritjen e prezencës kërcënuese të Rusisë rreth Detit Baltik, popullata në të dyja shtetet është duke u mësuar ngadalë me idenë e të hequrit dorë nga neutraliteti i tyre zyrtar.

Merkeli bisedon me kryeministrat e vendeve të 'Grupit të Vishegradit'

Berlin, 7 shkurt - Kancelarja gjermane Angela Merkel do të bisedojë në Bratislavë me kryeministrin e Sllovakisë, të Polonisë, të Çekisë dhe të Hungarisë për ta shënuar 30-vjetorin e rënien së "Perdes së hekurt".

Qeveria gjermane ka theksuar para takimit se ndryshimi politik në këto vende ka ndihmuar procesin e ribashkimit të Gjermanisë. Merkeli fillimisht do të takojë kryeministrin sllovak, Peter Pellegrini për të diskutuar çështjet ekonomike, të politikës së jashtme dhe ato evropiane. Megjithatë, Merkeli ka hasur në kundërshtimin e Polonisë dhe Hungarisë lidhur me politikën e saj të kufijve të hapur për refugjatët.

Polonia, ShBA-ja, shtetet baltike dhe disa vende të tjera të BE-së kanë shprehur gjithashtu shqetësime rreth projektit, tubacioni i dytë i gazit që lidh Rusinë drejtpërdrejt me Gjermaninë nën Detin Baltik. Kjo do të shmangte tubacionet ekzistuese të gazit përmes Ukrainës dhe kritikët kanë thënë se do të rriste varësinë e energjisë nga Rusia.

Kryeministri polak Mateusz Morawieck e ka quajtur tubacionin një armë të luftës hibride që Moska dëshiron ta përdorë për të minuar sigurinë evropiane të energjisë dhe solidaritetin e BE-së dhe NATO-s.

Sport

QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82

PROGNOZA SPORTIVE	CHIEVO - ROMA	2	MAINZ - LEVERKUSEN	1	DIJON - MARSEILLE	2

Dy synimet e Shillovës

Alban Shillova me Flamurtarin synim në këtë kampionat ka mbetjen në Superligë dhe triumfin në garën për golashënuesin më të mirë. "Synimi im dhe i klubit të Flamurtarit këtë vit dihet se është të jemi stabil dhe mos ta rrezikojmë rënien nga Superliga, e cila nuk besoj se do të ndodhë, për faktin se ky klub ka lojtarë cilësorë. Synimi tjetër është që, krahas rezultateve pozitive të skuadrës, të shënoj sa më shumë gola dhe ta fitoj çmimin e golashënuesit më të mirë në elitë", ka thënë Shillova

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

Prishtinë, 7 shkurt - Sulmuesi Alban Shillova ka qenë një nga futbollistët më të mirë në sezonin vjeshtor në IPKO Superligën e Kosovës në futboll si dhe golashënuesi më i mirë me nënta gola të shënuara. Sulmuesi Shillova të enjten për "Epokën e re" ka zbuluar dy synime që i ka për pranverë me skuadrën e Flamurtarit nga Prishtina: mbijetesën dhe triumfin në garën për golashënuesin më të mirë në elitë. "Synimi im dhe i Klubit të Flamurtarit këtë vit dihet se është të jemi stabil dhe mos të rrezikojmë rënien nga Superliga, e cila nuk besoj se do të ndodhë, pasi ky klub ka lojtarë cilësorë. Synimi tjetër është që, krahas rezultateve pozitive të skuadrës, të shënoj sa më shumë gola e, pse jo, ta fitoj edhe çmimin e golashënuesit më të mirë në elitë", ka thënë Shillova.

Sulmuesi ka folur edhe për përgatitjet që po i zhvillon skuadra kuqezi. Ai është shumë i kënaqur që kryesia e klubit ka arritur të dërgojë në përgatitje në dy vende të ndryshme, Shqipëri dhe Turqi. "Faza përgatitore po shkon shumë mirë. Klubi i Flamurtarit është bërë shumë serioz, duke na mundësuar që përgatitjet t'i zhvillojmë në dy shtete. Fazën e parë e kemi përfunduar me sukses në Durrës, kurse fazën e fundit të përgatitjeve jemi duke e mbajtur në Turqi. Normalisht se kushtet janë shumë të mira dhe shpresoj se do të kemi një fillim të mirë të kampionatit me rezultate pozitive", ka deklaruar ai.

Alban Shillova, pavarësisht prej mungesës në disa ndeshje në sezonin vjeshtor për shkak të lëndimeve, ka arritur të shënojë nëntë gola, një më shumë se Festim Alidema i Llapit dhe dy më shumë se Betim Haxhimusa i Gjilanit. Nga tre gola më pak të shënuara se Shillova i kanë shënuar Kastriot Rexha i Feronikelit dhe Martin Mirevski i Trepçës '89. Ndërsa skuadra e Flamurtarit sezonin vjeshtor e mbylli në pozitën e shtatë me 22 pikë të grumbulluar. Prej shtatëmbëdhjetë ndeshjeve të zhvilluara kjo skuadër regjistroi gjashtë fitore, katër barazime dhe shtatë humbje.

SHKURT

Renditja e Kosovës dhe Shqipërisë në ranglistën e FIFA-s

Përfaqësuesja e Kosovës në futboll është ngjitur për një pozitë në ranglistën e FIFA-s për muajin shkurt dhe tani pozicionohet në vendin e 130. Ndryshe nga Kosova, Kombëtarja e Shqipërisë ka pësuar rënie për një pozitë dhe pozicionohet në vendin e 61-të të ranglistës. Ndryshime nuk ka në krye të ranglistës së cilës i prin Belgjika, e përcjell nga Franca, Brazili, Kroacia dhe Anglia.

Ylli i Kosovës nxirret në shitje

Sulmuesi i Përfaqësueses së Kosovës, Donis Avdijaj, nuk do të jetë pjesë e skuadrës holandeze Willem II. Lajmi është konfirmuar nga mediet holandeze, të cilat bëjnë me dije se drejtuesit e Willemit e kanë nxjerrë Avdijajn në shitje. Avdijaj në fund të muajit dhjetor është suspenduar nga klubi për shkak të thyerjes së rregullave dhe në muajin e shkuar është larguar nga kampi stërvitor në Spanjë për shkak të lëndimit të gjurit. E ardhmja e Avdijajt mund të jetë në Rusi, Poloni, Suedi, Zvicër ose ShBA, pasi janë ligat e vetme ku afati kalimtar është ende i hapur.

Drenica mposhti Feronikelin, Llapi 'përmbysi' Vushtrrinë

Drenica e ka zhvilluar një ndeshje miqësore me skuadrën e Feronikelit nga Drenasi. Kuqezinjtë kanë arritur fitore me rezultat 2-1. Alush Gavazaj ka shënuar për Feronikelin, kurse për Drenicën Taulant Dajaku dhe Nicholas Andrews. Ndërkohë, në një ndeshje tjetër miqësore, Llapi e ka mposhtur Vushtrrinë 2-1. Për vushtrriasit në pjesën e parë shënoi Kastriot Selmanit, kurse për vendësit golat e fitores i realizuan Egzonin Sinanin dhe Mentor Zhdrellën. Në miqësoret e Ligës së Parë, Besa mundi Istogun 2-0 derisa Dukagjini fitoi ndaj Shkumbinit me rezultat 3-1.

Çeferini rizgjidhet president i UEFA-s, Duka anëtar i Komitetit Ekzekutiv

Romë, 7 shkurt - Presidenti aktual i UEFA-s, Aleksander Çeferin, do të vazhdojë të jetë në krye të futbollit evropian për katër vjetët e ardhshëm, pasi u rizgjodh për një mandat të dytë në Kongresin e rregullt të UEFA-s, i cili u mbajt në Romë, e ku po marrin pjesë edhe presidenti i FFK-së, Agim Ademi dhe sekretari i përgjithshëm, Eroll Salihu. 51-vjeçari slloven për herë të parë u zgjodh në krye të UEFA-s në shtator të vitit 2016, derisa sot u votua me aklamacion nga 55 anëtarët e UEFA-s për mandatin e ri katërvjeçar. Pasi mori besimin e federatave anëtare të UEFA-s u zotua për unitet, respekt dhe solidaritet për vazhdimin e punës së tij. "Faleminderit edhe një herë për besimin tuaj! Jam i emocionuar, njëherësh edhe i nderuar për besimin e dhënë. Futbolli do të mbetet i respektuar nga të gjithë", ka thënë Çeferin pas rizgjedhjes si president i UEFA-s. Ndërsa presidenti i Federatës Shqiptare të Futbollit, Armand Duka, është zgjedhur anëtar i Komitetit Ekzekutiv të UEFA-s, organizmit më të lartë drejtues të futbollit evropian. Në favor të Dukës votuan 36 federata anëtare nga 55 që ka UEFA në total, teksa dy vota kanë rezultuar të pavlefshme ndërsa pjesa tjetër, 17 ishin kundër.

Bajoku dhe Deliaj përfaqësojnë Kosovën në turneun e boksit "Bocskai Istvan"

PRISHTINË, 7 SHKURT - Boksierët Shpëtim Bajoku dhe Ardit Delijaj do ta përfaqësojnë Përfaqësuesen e Kosovës në boks në turneun e 63-të memorial ndërkombëtar "Bocskai Istvan", që mbahet deri më 9 shkurt në Debrecen të Hungarisë.
Turneu është në kalendarin zyrtar të Unionit Evropian të Boksit (EUBC), ndërsa marrin pjesë 30 shtete të botës. Në mesin e garuesve, sipas uebfaqes zyrtare të EUBC-së, pjesëmarrës në gara janë edhe kampion të botës dhe medalistë olimpikë. Bajoku do të garojë në kategorinë deri në 61 kilogramë, kurse pas shortit të hedhur, ai në luftën e parë do të ndeshet me moldavin, Cvasius Migail. Delijaj përballë do ta ketë spanjollin Aleksando Camacho Fernandez, në kategorinë deri në 81 kilogramë.

Pallacanestro Varese, kundërshtare e Prishtinës në FIBA Europe Cup

PRISHTINË, 7 SHKURT - Z Mobile Prishtina, pas shortit të tërhequr të enjten në Munchen, e ka mësuar emrin e kundërshtarit në mesin e 16 ekipeve më të mira në FIBA Europe Cup. Pallacanestro Varese nga Italia do të jetë rivali i radhës i Z Mobile Prishtinës, me ndeshjen e parë që do të luhet në kryeqytetin e Kosovës më 6 mars, më pas me ndeshjen e kthimit që do të luhet më 13 mars në Itali. Skuadra që do ta shënojë rezultatin më të mirë nga dy ndeshjet do të avancojë për në çerekfinale të FIBA Europe Cup. Duhet theksuar se Z Mobile Prishtina të mërkurën mbrëma në Pallatin e Rinisë dhe Sporteve në Prishtinë e ka mposhtur ekipin turk Pinar Karsiyaka me rezultat 82-78. Me këtë fitore dhe në një atmosferë mbresëlënëse të krijuar nga tifozët e pranishëm në palestër

skuadra nga kryeqyteti e ka siguruar një vend në mesin e 16 skuadrave më të mira të FIBA Europe Cup dhe kështu e ka arritur një sukses që kurrë më parë nuk e ka arritur një klub shqiptar në garat ndërkombëtare.

ÇIFTET FIBA EUROPE CUP

Donar Groningen (Ned) - Filou Oostende (Bel)
Pinar Karsiyaka (Tur) - Ventspils (Lat)
Alba Fehervar (Hun) - Telekom Baskets Bonn (Ger)
Ironi Ness Ziona (Isr) - Bakken Bears (Den)
Balkan BC (Bul) - Unet Holon (Isr)
Dinamo Sassari (Ita) - ZZ Leiden (Ned)
Pallacanestro Varese (Ita) - Z Mobile Prishtina (Kos)

Golden State nuk ka rival në NBA

OAKLAND, 7 SHKURT - Golden State Warriors i jep leksion edhe San Antonio Spursit, duke i treguar se në NBA ligjin e bëjnë ai. Për ta konfirmuar supermacinë dhe për t'u treguar të gjithëve se është favorit kryesor në garën për titullin kampion, Golden State triumfoi me rezultatin 141-102 ndaj ekipit teksan.
Në "Oracle Arena" nuk kishte aspak histori me kampionët në fuqi të NBA-s që zgjidhën gjithçka që në pjesën e parë. Klay Thompson me 26 pikë ishte më i miri mbi parket për Warriorsin në këtë sfidë, ndërkohë që Kevin Duranti dhe Steph Curry shtuan 23, respektivisht 19 pikë, edhe pse diferencën mes dy skuadrave e bëri loja në grup e Golden States. Kjo ishte fitorja e 38 në 53 ndeshje për skuadrën e trajnerit Steve Kerr që tashmë nuk e diskuton më kreun e renditjes në Perëndim për sa i përket sezonit të rregullt, raporton "SS".
James Hardeni vazhdon të impresionojë, ndërkohë që Houston Rocketsi fiton sërish. 36 pikë realizoi ylli i Houstonit në suksesin e lehtë me shifrat 127-101 brenda në Kaliforni përballë Sacramento Kingut, skuadër që po kalonte një moment shumë pozitiv, por që u dorëzua përballë klasës që zotëron Hard i skuadrës teksane. Te Rocketsi në këtë duel spikati

edhe Greeni me 25 pikë.
Nuk njeh limite në këtë sezon Milwaukee Bucks që regjistroi fitoren e 17 në 20 ndeshjet e fundit, pasi theu në Wincosin, me rezultat të thellë 148-129, Washington Wizardsin, sfidë në të cilën diferencën e bëri i përhershmi Giannis Antetokounmpo, autor i 43 pikëve, ndërsa e ndihmoi Milwaukee edhe me 4 asistime e 6 rikuperime poshtë tabelës.
Kryeqytetasve në krahun tjetër nuk u mjaftuan 30 pikët e Bradley Bealit. Vijon momenti jo për Denver Nuggetsin. Skuadra nga Colorado pësoi humbjen e dytë rresht pasi u mposht nga Brooklyn Netsi me rezultatin 135-130. Thjesht, fantastik edhe një herë tjetër D'Angelo Russell, i cili koleksionoi në total 27 pikë, 11 asistime e 6 rebounde. Teksa Los Angeles Lakers vazhdon të vuajë te Brooklyn Nets po mrekullohen çdo ditë e më shumë nga paraqitjet e talentit D'Angelo Rusell, i cili po i çon i vetëm në "play-off" dhe nuk u mbetet gjë tjetër veçse ta falënderojnë Lakersin për dhuratën që u bënë duke u dhënë një talent si Russell në verën e vitit 2017 për të marrë në shkëmbim një "kartë të djegur" si Brook Lopez i cili, pas një sezoni te kalifornianët, tashmë është pjesë e Milwaukee Bucksit. Këto paraqitje kanë bërë që 22-vjeçari Russell të jetë një nga lojtarët e All Star Games të këtij viti. Te Denveri shkëlqeu i përhershmi Nikola Jokiq, por shifrat e dyfishta në çdo aspekt të lojës të yllit serb nuk mjaftuan që Nuggetsi ta evitojë humbjen.

SHKURT

Nxirret trupi nga aeroplani i Emiliano Salas

Një trup është nxjerr nga rrënojat e aeroplanit që ishte rrëzuar me sulmuesin Emiliano Sala dhe pilotin David Ibbotson në bord. Aeroplani "Piper Malibu" ishte gjetur në Kanalin Anglez të dielën në mëngjes, por baticat e forta kanë pamundësuar nxjerrjen e menjëhershme të trupit që ishte parë në rrënoja. "Pas ekzaminimit vizual të vendit të aksidentit, ne nisëm operacionin për nxjerrjen e trupit", thuhet në njoftimin e Zyrës për Hetimin e Aksidenteve Ajrore. "Në kushte sfiduese, AAIB dhe specialistët me sukses kanë nxjerrë trupin nga rrënojat. Operacioni ka shkuar me dinjitet dhe familjet janë informuar për progresin e operacionit", ka shtuar kjo zyrë. "Trupi është dërguar në Portland për t'u marrë në kujdesin e kirurgut në Dorset. Presim që raporti i brendshëm të publikohet brenda një muaji që prej aksidentit", thuhet më tej.

Vrsaljko largohet nga Interi

Sime Vrsaljko do të kthehet në Atletico Madrid për shkak se Interi ka vendosur kundër blerjes së tij si pasojë e lëndimit. Sipas "Gazzetta dello Sport", aventura e Vrsaljkos me Interin ka marrë fund pasi u mësua se lëndimi i tij në gju merr plot gjashtë muaj kohë për t'u rikuperuar. Kroati iu bashkua Interit nga Atletico si lojtar i huazuar për 6.5 milionë euro me mundësinë që zikaltrit e kanë për ta blerë për 17.5 milionë euro, por ai ka bërë vetëm 13 paraqitje deri tani këtë sezon.

Barça nuk e dëshiron Neymarin, Iscon po

Barcelona nuk është duke planifikuar që ta rikthejë brazilianin nga Paris Saint Germain, Neymar. Skuadra spanjolle është e interesuar për mesfushorin e Real Madridit, Isco. Kështu së paku ka bërë me dije presidenti i klubit katalunas, duke konfirmuar interesimin për Iscon. "Kurrë nuk kam folur për Neymarin me parisienët dhe askush nuk i ka bërë thirrje të kthehet në Barcelonë. Ne jemi duke u përgatitur për sezonin e ardhshëm, por Neymari nuk është në listë", ka thënë Bertomeu për "Marca". "Nëse trajneri kërkon një lojtar të largohet nga Madridi, natyrisht, se ne jemi të gatshëm për të nënshkruar. Nuk ka asnjë pakt mes dy klubeve. Të gjithë po përpiqemi për të bërë një ekip të mirë. Ne do të flasim me Realin për Iscon", ka deklaruar Bertomeu.

Wengeri ka katër oferta

Trajneri francez Arsene Wenger i ka dhënë fund qëndrimit 22-vjeçar tek Arsenali në fund të sezonit të kaluar, ku është zëvendësuar nga Unay Emery. Pas largimit nga Arsenali, trajneri francez ka pranuar disa oferta të klubeve të ndryshme të Evropës, duke u përmendur si kandidat potencial për ta marrë drejtimin e Bayern Munchenit, Barcelonës dhe Real Madridit. "The Times" raporton se 67-vjeçari do t'i rikthehet futbollit, duke pranuar një nga katër ofertat e paraqitura në tavolinë. Besohet se një ofertë vjen nga PSG-ja për një rol drejtues në skuadër, një tjetër nga një ekip kombëtar dhe dy oferta të tjera nga dy skuadra të Evropës.

Insigne, pasardhës i Hazardit te Chelsea

Eden Hazard do të transferohet te Reali i Madridit në verë me shumë mundësi. Belgu e ka shprehur disa herë dëshirën e tij për të luajtur me kampionët në fuqi të Evropës dhe Chelsea po punon për ta gjetur zëvendësuesin e tij. Në fillim u përfol për një interesim kundrejt Coutinhos, por presidenti i Barcelonës mohoi mundësinë e shitjes së brazilianit. Trajneri Maurizo Sarri ka hedhur sytë nga Italia dhe "Daily Mail" zbulon objektivin e trajnerit italian. Ai është Lorenzo Insigne, me të cilin Sarri ka punuar te Napoli. 27-vjeçari shihet si pasuesi perfekt i Hazardit dhe Chelsea do të tentojë t'i sigurojë shërbimet e sulmuesit italian në verë. Presidenti De Laurentis refuzoi 70 milionë euro nga Liverpooli dhe "Blutë e Londrës" nuk do ta kenë aspak të thjeshtë të mbërrijnë tek Insigne.

REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK– MUNICIPALITY OF JUNIK

Nr. I-180/02/19
Junik
Dt.08.02.2019

Në bazë të nenit 13 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/040, dhe nenit 6 paragrafi 5, të Udhëzimit Administrativ (MPMS) Nr.07/2017, për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, Statutit të Komunës, Komuna e Junikut bënë:

S H P A L L J E TË K O N K U R S I T

1. Për përzgjedhjen e Drejtorit të Shkollës Fillore dhe e Mesme e Ulët **"Edmond Hoxha"** në Junik

Kualifikimet, shkathtësitë, aftësitë dhe përvoja:

- ✓ Kërkohet Kualifikimi i arsimit universitar të nivelit themelor (së paku kualifikimin prej 240 ECTS/4 vite të shkollimit universitarë), nga profilet e pranueshme për pozitën e mësimdhënësit sipas udhëzimit për licencimin e mësimdhënësve dhe normativit mbi punësimin e kuadrit mësimor dhe rregullativës tjetër ligjore;
- ✓ Të ketë licencë të rregullt të mësimdhënësit dhe ata që janë në procedurë të licencimit;
- ✓ Të kenë përfunduar me sukses një program të akredituar të kualifikimit profesional për udhëheqje, administrim ose menaxhim;
- ✓ Të ketë së paku 3 vjet përvojë punë në arsim ose në institucione të arsimit.

Të posedojnë këto dokumente;

- Certifikatën e lindjes;
- Diplomën e fakultetit të kryer për nivelin përkatës;
- Dëshminë për përvojën e punës;
- Protofolion profesionale;
- Letër reference nga një institucion publik-kredibil (MASHT,DAKRS,Këshilli drejtues i shkollës, punëdhënësi paraprak, institucionet e arsimit të lartë)
- Letrat e referencës duhet të kenë përmbajtje dëshmuese për punën dhe angazhimet paraprake;
- Plani zhvillimor të institucionit edukativo-arsimorë dhe aftësues për të cilin ka konkurruar (së paku 10 faqe tekst me hapësirë 1.5, fonti i shkronjave 12)
- Njohuri në përdorimin e kompjuterit dhe të programeve themelore të
- Microsoft Office (dëshmi nëse ka);
- Certifikatën shëndetësore të lëshuar nga një institucion publik shëndetësor me të cilën dëshmohet gjendja e tij/saj shëndetësore
- Dëshminë se nuk është nën hetime.

Detyrat kyçe:

- ➢ Përpunon dhe koordinon lëndët, informatat, organizon ecurinë e punëve, takimeve ditore dhe prezantimeve dhe përpunon dokumentacionin e drejtpërdrejt që ka të bëjnë me procesin edukativo-arsimor;
- ➢ Kujdeset për komunikim me palët dhe për komunikim elektronik me akterët relevantë;
- ➢ Asiston në përgatitjen e dokumentacionit dhe materialeve të nevojshme të kërkuara nga i tërë personeli i shkollës, DAKRS MASHT-it, si dhe për Bordin e shkollës;
- ➢ Bën kontrollimin profesional të cilësisë mësimore, organizative në të gjitha nivelet arsimore në bashkëpunim me trupat e tjera të institucionit, DAKRS, MASHT-it;
- ➢ Drejtori i shkollës të punojë së bashku me stafin dhe shërbimet tjera që të sigurojë arsim cilësor për të gjithë nxënësit;
- ➢ Drejtori i shkollës, së bashku me Bordin e shkollës, këshillin e shkollës DAKRS do të përgatitë dhe menaxhojnë autonominë financiare të shkollës sipas formulës së financimit;
- ➢ Të kryen punë dhe detyra tjera që i ngarkohen nga DAKRS dhe MASHT-i në interes për shkollën;
- ➢ Koeficienti për drejtor në Gjimnaz : 8.4
- ➢ Orari i plotë

Dokumentet e pakompletuara nuk do të merren në shqyrtim;
Kërkesat e dërguara pas datës së fundit nuk do të pranohen;

Kandidatët aplikacionin (formularin për konkurim) mund ta tërheqin në zyrën e pritjes Komuna e Junikut ku edhe i dorëzojnë aplikacionet e plotësuara;

Afati për paraqitjen e dokumentacionit është 15 ditë nga dita e shpalljes së konkursit në gazetën ditore (08.02.2019-22.02.2019), Për ditën e testit, kandidatët do të njoftohen me kohë përmes telefonit.

Udhëheqësja e personelit:
Venera Shala

Republika e Kosovës-
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada – Government

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kvalifikacije
National Qualification Authority

KONKURS

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve njofton se është hapur konkursi për aplikim të ekspertëve me marrëveshje për shërbimet e veçanta, për t'u bashkuar me panelet e ekspertëve që ndërmarrin veprimtari për verifikimin e standardeve të profesionit si dhe në procesin e validimit të kualifikimeve dhe akreditimit të Institucioneve të Arsimit dhe Aftesimit Profesional për:

- **Gjuhë Gjermane**

Kandidatët duhet të plotësojnë këto kushte:

- ➢ Të kenë kualifikim përkatës të arsimit të lartë;
- ➢ Të jenë të kualifikuar dhe të kenë përvojë profesionale së paku 10 vite në fushën përkatëse;
- ➢ Të kenë së paku 5 vjet përvojë punë në arsim, menaxhim apo të ngjashme;
- ➢ Të kenë përfunduar trajnime për vlerësim, zhvillim të kurrikulit, zhvillim të programeve;
- ➢ Të kenë njohuri të teknologjisë informative.

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- ➢ Ekspertët e përzgjedhur do të nënshkruajnë kontratë konfidenciale me AKK,
- ➢ Shqyrtojnë aplikacionet dhe gjithë dokumentacion e ofruesve të AAP për akreditim të institucioneve,
- ➢ Realizojnë vizita në terren,
- ➢ Bashkëpunojnë me anëtarët e tjerë të panelit, diskutojnë dhe harmonizojnë qëndrimet e tyre,
- ➢ Kontribuojnë në përgatitjen e një raporti që përcakton të gjeturat (gjetjet) dhe rekomandimet në lidhje me akreditimin e institucioneve,
- ➢ I raportojnë Drejtorit të AKK.

Inkurajohen të gjithë të interesuarit të cilët i plotësojnë kushtet, ti paraqesin dokumentet si në vijim:

- ➢ CV në formatin europass;
- ➢ Diplomat (e noterizuar) dhe certifikatat;
- ➢ Referencat.

Dokumentet që nuk I plotësojnë kushtet dhe kriteret e lartëcekura nuk do të shqyrtohen.
Aplikimi bëhet vetëm në formë elektronike tek **donjeta.nimani@rks-gov.net.**

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve,
Rr. Agim Ramadani p.n, Qendra e Studentëve , Prishtinë.
Tel: 038- 212 595
Afati i aplikimit: Nga data 08.02.2019 do 14.02.2019.
Për më shumë klikoni: ëëë.akkks.rks-gov.net

Republika e Kosovës-
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada – Government

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kvalifikacije
National Qualification Authority

KONKURS

Nacionalni autoritet za kvalifikacije objavljuje da je otvoren konkurs za prijavu eksperata za Ugovor o posebnim uslugama da se pridruže panelima eksperata koji preduzimaju aktivnosti za verifikaciju standarda profesije, kao i proces validacije kvalifikacija i akreditacije institucija Profesionalnog obrazovanja i osposobljavanja iz:

- **Njemački jezik**

Kandidat mora da ispunjava sledeće uslove:

- ➢ Da imaju odgovarajuće kvalifikacije visokog obrazovanja;
- ➢ da budu kvalifikovani i da imaju profesionalno iskustvo najmanje 10 godina u relevantnoj oblasti;
- ➢ da ima najmanje 5 godine radnog iskustva u obrazovanju, menađiranju ili slično;
- ➢ da ima završen trening za evaluaciju, razvoj kurikuluma, razvoj programa;
- ➢ da imaju znanje o informativnoj tehnologiji.

Zadaci i odgovornosti:

- ➢ Izabrani eksperti će potpisati poverljivi ugovor sa NAK,
- ➢ Razmatraju aplikacije i svu dokumentaciju ponuđaća POO-a za akreditaciju institucija,
- ➢ Obavljaju posete na terenu,
- ➢ Sarađuju sa ostalim članovima panela, diskutuju i usklađuju njihove stavove,
- ➢ Doprinose u pripremi izveštaja koji sadrži nalaze i preporuke u vezi akreditaciju institucija,
- ➢ Izvestava direktora NAK-a.

Podstiču se svi zainteresovani koji ispunjavaju uslove, da dostave sledeća dokumenta:

- ➢ CV formata europass;
- ➢ Diplome i certifikati;
- ➢ Preporuke.

Dokumenta koji ne ispunjavaju gorenavedene uslove i kriterijume neće se razmatrati.
Prijavljivanje se vrši samo u elektronskoj formi na mail **donjeta.nimani@rks-gov.net.**

Nacionalni autoritet za kvalifikacije,
Ul. Agim Ramadani b.b, Studentski centar, Priština.
Tel: 038- 212 595
Roka za prijavu: od dana 08.02.2019 do 14.02.2019.
Za više informacije kliknite na: www.akkks.rks-gov.net

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada - Government
Shërbimi Spitalor dhe Klinikë Universitar i Kosovës (SHSKUK)-Univerzitetske Bolničke i Kliničke Sluzbe Kosova (UBKSK)- Hospital and University Clinical Service of Kosovo (HUCSK)
Sektori i Personelit SHSKUK

Nr.prot.13 dt.07.02.2019, Prishtinë

Në bazë të nenit 8, parag. 1 e 2 të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212, nenit 4, të Udhëzimit Administrativ (MPMS) nr. 07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit Publik, nenit 6, 10,13 dhe 18 të Statutit të Shërbimit Spitalor dhe Klinikë Universitar e Kosovës, (SHSKUK), si dhe nenit 62 paragrafi 6 të Ligjit Nr. 04/L-125, për Shëndetësi, nenit 5 të Rregullores mbi Marrëdhënien e Punës nr. 1003 datë 21.07.2016, Statutit të Spitaleve të datës 07.04.2016, Vendimit nr. 47 dt: 12.01.2018 dhe Propozimit nr. 116 datë 26.01.2018 të Bordit Drejtues të SHSKUK-së, dhe E-mailit datë 06.02.2019, Drejtori i Përgjithshëm i SHSKUK-së publikon:

KONKURS

Institucioni: Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës (SHSKUK)

Titulli i vendit të punës: Drejtor i nivelit dytësor të kujdesit shëndetësor, si në vijim:

1. Drejtor i Spitalit të Përgjithshëm në Prizren; dhe
2. Drejtor i Spitalit të Përgjithshëm në Gjakovë;

Kohëzgjatja e kontratës: 3 vjeçare më mundësi të ri-zgjedhjes edhe një mandat tjetër
Koeficienti i pagës: 12.0
Raporton: Drejtorit të Përgjithshëm të SHSKUK-së
Orari i punës: 40 ore ne javë
Periudha provuese: 90 ditë sipas KKS-së
Nr. i Referencës: DP-SHSKUK - 03/2019-2/2

Kërkesat e përgjithshme për detyrën:

1. Udhëheq me punët operative dhe administrative të institucionit shëndetësor të nivelit dytësor të SHSKUK;
2. Koordinon aktivitetet e gjithmbarshme shëndetësore, financiare dhe administrative te njësisë organizative të SHSKUK;
3. Monitoron performancën profesionale dhe afarizmin financiar të njësisë organizative të SHSKUK;
4. Mbikëqyr zbatimin e përzgjedhjes së shefave dhe stafit tjetër menaxhuese të njësisë organizative të SHSKUK në bazë të Konkursit të shpallur ne pajtim me ligjin;
5. Siguron transparencën ligjore të punës dhe veprimtarisë te nivelit dytësor te SHSKUK;
6. Përgatitë për Drejtorin e Përgjithshëm të SHSKUK raporte të rregullta pune (javore, mujore, tre dhe 6 mujore si dhe raportin vjetor);
7. Përgatitë për Drejtorin e Përgjithshëm raportet periodike mujore me deklaratën përcjellëse financiare;
8. Merr pjesë në mënyrë obligative në takimet me Drejtorin e Përgjithshëm të SHSKUK-së;
9. Përgatitë raporte plotësuese mbi aktivitetet e njësisë organizative te SHSKUK më kërkesë të Drejtorit te Përgjithshëm;
10. Përgatitë raporte të tjera analitike me rendësi, në pajtim me ligjin;
11. Ushtron veprimtarinë e tij në bazë të Ligjit për Shëndetësi, dhe tjera të SHSKUK-së si dhe të Rregulloreve të Brendshme;
12. Bën vlerësimin e performancës individuale të të gjithë stafit menaxherial të njësisë organizative të SHSKUK;
13. Përgatitë raporte specifike sipas kërkesave për Drejtorin e Përgjithshëm të SHSKUK-së dhe Bordin Drejtues të SHSKUK-së;

Detyrat kryesore

1. Siguron udhëheqje efektive dhe efikase të njësisë organizative të SHSKUK te cilën e menaxhon;
2. Zbaton politikat e Ministrisë së Shëndetësisë dhe SHSKUK-së përkitazi njësinë organizative të cilën e menaxhon;
3. Ofron alternativa, udhëzime dhe orientime strategjike të zhvillimit të nivelit dytësor të SHSKUK të cilën e menaxhon;
4. Siguron funksionimin e strukturës efikase menaxhuese brenda institucionit dhe në mënyrë të qartë identifikon nivelet e përgjegjësisë dhe obligimet brenda institucionit;
5. Siguron zhvillimin e të gjitha procedurave dhe politikave të domosdoshme administrative për menaxhimin efikas dhe efektiv në institucion;
6. Siguron sistemin e rishikimit të brendshëm efektiv duke përfshirë ankesat dhe çështjet legale të bazuara në procedura ligjore, si dhe mundëson raportimin zyrtar të rezultateve;
7. Siguron implementimin dhe mbikëqyrjen e veprimeve përmirësuese nga raportet e pranuara nga mbikëqyrja e jashtme dhe e brendshme;
8. Është nën përgjegjësin e drejtpërdrejtë të drejtorit dhe stafit nën menaxhimin e tij, implementimi i dokumenteve strategjike të miratuara nga Qeveria e Republikës se Kosovës, Ministria e Shëndetësisë dhe Bordi Drejtues i SHSKUK si dhe raportimi përkitazi me to;
9. Siguron procesin e revizionit efektiv në institucion dhe revizione periodike në mënyrë të vazhdueshme, ndan rezultatet, zbaton dhe mbikëqyr veprimet përmirësuese;
10. Siguron përgatitjen e planit vjetor të biznesit, diskutimin e tij si dhe harmonizimin me Drejtorin e Përgjithshëm dhe përmes tij me Bordin Drejtues të SHSKUK;
11. Siguron zhvillimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të biznesit të institucionit;
12. Siguron se institucioni ka përgatitë strategjinë e shërbimit që pasqyron direktivat e strategjisë së përgjithshme shëndetësore të SHSKUK;
13. Siguron zhvillimin e imazhit pozitiv të brendshëm dhe të jashtëm te institucionit dhe ndërton raporte të mira me publikun dhe mediat;
14. Siguron transparencë të funksionimit të institucionit, përgatit, publikon dhe ndan me palët e interesuara raportet vjetore të punës së institucionit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi;
15. Krijon kushte optimale për punë për stafin e institucionit dhe zhvillon programe konkrete për zhvillimin dhe avancimin profesional të tyre;

Shkollimi i kërkuar:

- Të ketë arsimim të lartë universitar, thirrje akademike, ose të kenë titullin e doktorit të shkencave, magjistër i Mjekësisë apo specialist në njërën nga degët e Mjekësisë;
- Të ketë titullin e doktorit të shkencave, magjistër i shkencave juridike, Jurist i diplomuar dhe të tjera;
- Të ketë titullin e doktorit të shkencave magjistër i shkencave ekonomike, Ekonomist i diplomuar dhe të tjera;
- Përparësi me rastin e përzgjedhjes do të kenë kandidatët me kualifikime të veçanta në lëmin e menaxhmentit shëndetësor;

Aftësitë / përvoja dhe atributet e tjera që kërkohen:

- Se paku pesë (5) vjet përvojë pune, prej tyre tre (3) vjet në poste udhëheqëse.
- Shkathtësi në përcaktimin dhe arritjen e objektivave strategjike;
- Njohja e mirë e sistemit shëndetësor dhe organizimit të punës së institucioneve të kujdesit shëndetësor;
- Njohuri e legjislacionit në përgjithësi dhe të atij të fushës së shëndetësisë në veçanti;
- Njohuri në fushën e menaxhimit të financave publike;
- Aftësi te mira komunikuese në të folur dhe në të shkruar,
- Aftësi për pune ekipore;
- Njohja e punës me kompjuter (Word, Excel etj);
